

FAMILJA NJË REALITET QË SHOQËRON NJERIUN

QENDRA E TRAJNIMIT “KARDINAL MIKEL KOLIQI”



SHOQATA INTERNACIONALE
PËR SOLIDARITETIN



QENDER TRAJNIMI
Kardinal Mikel Koliqi

Familja vend. i mirëpritjes dhe besimit që gjeneron shpresë

Mauro Giuseppe Lepori

Falenderojmë për kontributin e dhënë në bartimin e dispensave pjesëtare e grupit të punës të shoqatës profesionale DIESSE, Didaktikë dhe Risi Shkollore në Milano, të koordinuar nga prof. Felice E. Crema, docent i historisë së pedagogjisë pranë Universitetit Katolik të S.C të Milanos dhe konsulent i Qendrës së Trajnimit 'Kardinal Mikel Koliqi' Tiranë, Shqipëri.

Në vecanti, gjithsecilin mbi kompetencën e tij: Fabrizia Alliora, psikologe; Maria Pia Babini përgjegjëse e koordinimit të Fism Bologna; Laura Bertolotti, eksperte formimi ANSAS; Marco Coerezza, përgjegjës koordinimi Fism Varese; Giulietta Loreti, psikologe; Rosanna Restaino, koordinatore pedagogjike e Fism Bologna; Rosa Maria Rioli, eksperte formimi; Lara Vannini, koordinatore pedagogjike e Fism Bologna.

Falenderojmë për kontributin e dhënë në bartimin e përmbajtjes, redaktimit dhe supervizimit të kësaj dispense MA Miranda Mulgeci, drejtoreshë e Qendrës së Trajnimit "Kardinal Mikel Koliqi" Tiranë, Shqipëri.

Falenderojmë gjithashtu për bashkëpunimin e saj Znj. Bjeshtë Mrishaj, formatore pranë Qendrës së Trajnimit "Kardinal Mikel Koliqi" Tiranë.

Tiranë, Maj 2011

Ky material u realizua me mbështetjen e:



FONDACIONIT ITALIAN AVSI



ZYRËS LOKALE TË

KOOPERIMIT ITALIAN PËR ZHVILLIM



QENDRA E TRAJNIMIT

'KARDINAL MIKEL KOLIQI'

Falenderojmë për përkthimin e materialit në shqip Cosmos Agency .

Materiali do të jetë i disponueshëm dhe on line në formatin pdf në faqen e internetit www.shisalbania.org

Gjithashtu është i disponueshëm në formatin e shtypur pranë Qendrës së Trajnimit

'Kardinal Mikel Koliqi' në Tiranë.

Formulimi grafik:  deltaprint@albmail.com Shtypi:  **Gentgrafik**

Të gjitha të drejtat ekskluzive të Shoqatës Internacionale për Solidaritet (SHIS) Tiranë 2011.



SHOQATA INTERNACIONALE PER SOLIDARITETIN

Adresa: Rr. Vaçe Zela Nr. 19, Njësia 7, 1023 Tirana, Albania.

Tel/fax +355 4 2263209; Kutia Postare 108

e-mail: shis@shisalbania.org

Neni 16 i *Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut* shpall:

1. Burrat dhe gratë, në moshë të përshtatshme, kanë të drejtën që të martohen dhe të krijojnë një familje, pa asnjë kufizim race, shtetësie apo feje. Ata kanë të drejta të barabarta përsa i përket martesës, gjatë martesës, si edhe gjatë zgjidhjes së saj.
2. Martesa mund të arrihet vetëm me pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve të ardhshëm.
3. Familja është bërthama natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën që të mbrohet nga shoqëria dhe nga Shteti.

Neni 29 i *Kushtetutës së Republikës Italiane* e njeh familjen si 'shoqëri natyrore të themeluar mbi martesën, të rregulluar mbi barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, me kufijtë e përcaktuar nga ligji për të garantuar unitetin familjar”.

Në *sistemin juridik shqiptar* madje është i pranishëm edhe një kod specifik, i cili i kushtohet në mënyrë ekskluzive së drejtës së familjes.

Janë këta tre shembuj, ndër të shumtët që mund të silleshin, të cilët tregojnë rëndësinë që familja ka pasur dhe vazhdon të ketë në shoqëri, pavarësisht nga ndryshimet e mëdha – veçanërisht ndikues qoftë në mënyrat e prodhimit (industrializimi), qoftë në marrëdhëniet ndërmjet popujve (globalizimi) – që kanë ndodhur në botë gjatë dy shekujve të fundit dhe që, në mënyrë të pashmangshme, i kanë parashtruar, dhe vazhdojnë t'i parashtruar, shumë pyetje këtij institucioni, të cilit i është kërkuar që t'u japë përgjigje të përshtatshme kushteve të reja shoqërore dhe ekonomike dhe që të bëhet një mbartëse e vetëdijshme e mënyrave të reja me të cilat do t'i jepej përgjigje kërkesës së njeriut për të mos qenë i vetëm. Mënyra se si i duhet përgjigjur kësaj kërkesë i drejtohet temës së kalimit të brezave dhe, domethënë, atë të edukimit, një temë për të cilën nevojiten përgjigje më të përshtatshme sesa ato që janë propozuar deri më sot.

Evolucioni i ngadalshëm që, duke u nisur nga një formë e parë me të cilën Familja paraqitet në skenën e botës, e ka shoqëruar gjithmonë historinë e saj, por që pëson në këta dy shekujt e fundit një përshpejtim të menjëhershëm. Prandaj nuk është një rastësi që, mbas disa vjeçareve, gjatë të cilëve institucioni familjar dukej i pranuar paqësisht në format e ndryshme që, në kohë dhe në hapësirë, ajo ka marrë, në fillim të shekullit XIX bëhet objekt i një reflektimi kritik në të cilin kanë marrë pjesë të gjitha shkencat shoqërore, secila prej tyre duke ofruar një kontribut të vetin specifik që na bën të mundur sot të jemi më të vetëdijshëm për rolin që ka familja në rritjen e njeriut dhe të të gjithë njerëzimit dhe për përgjegjësinë që për këtë kemi kundrejt saj, si elementë të veçantë dhe si pjesë e një konteksti shoqëror më të gjerë.

FAMILJA: NJË REALITET QË NGAHERË E SHOQËRON NJERIUN.

Prejardhja e termit gjendet në Romë (*familia*), por karakteristikat konkrete që merr familja janë të lidhura kryesisht me aspektet shoqërore dhe politike, përveç atyre ekonomike që karakterizojnë kontekstet e ndryshme. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së Romës, që nga republika dhe deri te rënia e perandorisë, 'domus', domethënë banesa, përfaqëson jo vetëm një vend fizik, por edhe një botë, të rregulluar nga pushteti i Babait të familjes (Paterfamilias): instituti i 'birësimi', që përcakton ligjërisht dhe jo biologjikisht gjendjen e 'birit' është një shembull i qartë që tregon se sa i gjerë ishte ky pushtet; 'familii' janë jo vetëm njerëzit e të njëjtët gjak, por edhe të gjithë ata që, në çfarëdolloj cilësie jetojnë në të njëjtën banesë (domus). Një shembull i mëtejshëm i rëndësisë së familjes në shoqërinë romake është përfaqësuar nga një prej institucioneve kryesore të saj, 'Senati', i cili e shoqëron sistemin politik të Romës nëpërmjet të gjitha ndryshimeve të mëdha që kanë pasuar në shekuj, përbërja e të cilit mbetet gjithmonë përfaqësuese e familjeve më të lashta romake.

Ndryshimet edhe të rëndësishme që ndodhin me kalimin e shekujve, në mënyrë të veçantë nën ndikimin fetar dhe kulturor të Krishtërit, janë rezultati i një procesi të ngadalshëm, dhe shpesh jolinear, që i bën të mundur trupit shoqëror ta metabolizojë atë, edhe pse nuk e ndryshojnë vështrimin që shihet familja kryesisht dimensionin e saj shoqëror dhe politik.

Shekujt XVII dhe XVIII përfaqësojnë një pikë kthese vendimtare edhe përsa i përket familjes. Në një moment të parë ajo vazhdon të konsiderohet si modeli i qëndrueshëm i marrëdhënies shoqërore së cilës edhe shteti që është duke lindur duhet t'i drejtohet: paternalizmi që do të karakterizojë absolutizmin e viteve 700 (shtatëqind) paraqitet në analogji me organizimin familjar, si forma më racionale sipas së cilës mund të organizohet edhe bashkëjetesa e një populli. Por shumë shpejt kjo perspektivë vihet në krizë qoftë nga industrializimi fillestar, që duket se e ndryshon rrënjësisht rolin e familjes si 'qeliza themelore' e të vepruarit ekonomik – shoqëror, qoftë nga shfaqja gjithmonë e më e qartë e pretendimit të shtetit për të përfaqësuar referimin e parë për të gjitha aspektet domethënëse të jetës shoqërore të njeriut për çdo individ të veçantë. Revolucioni francez është momenti në të cilin kjo dialektikë shpalolet me qartësi, duke i sqaruar dy paradigmat, duke u nisur nga të cilat maten dhe përcaktohen sistemet e reja shoqërore: antagonizmi shtet - shoqëri; kontradikta e hapur konservatorizëm - përparim.

Prandaj edhe nuk duhet të habisë fakti që shkencat shoqërore të porsalindura kanë si pikënisjeje të reflektimit mbi familjen vendin që ajo ka në shoqëri dhe rolin e saj antagonist kundrejt formave që merr shteti. Në këtë perspektivë shfaqet ajo që shumë shpesh ende edhe sot përfaqëson një stereotip kulturor: familja në qendër të një sistemi shoqëror tradicional (dhe domethënë vend i konservatorizmit) dhe shteti në qendër, madje motor i një sistemi të ri shoqëror të hapur ndaj përparimit.

Familja: një realitet që ngaherë e shoqëron njeriun.

Kjo qasje e parë ndikon fuqimisht mbi sociologjinë që në gjysmën e parë të shekullit XIX, dallon pikërisht te familja një ndër objektet më domethënëse të studimit, nëpërmjet të cilit të lexohet ndryshimi i madh që po ndodh, jo vetëm një moment kalimtar, por gjithmonë e më qartë një karakteristikë e përhershme e një epoke të re të historisë: 'modernizmi'.

F. Le Play që i pari i një sërë studiuesish që parashtruan pyetjen se çfarë paraqiste familja në organizimin shoqëror, duke e konsideruar për disa aspekte plotësuese, për disa të tjerë si alternativë e shtetit, në formën në të cilën ishte duke u përvijuar në të gjithë Europën. *Le Play*-it i detyrohet formulimi i parë i asaj skeme 'zhvilluese' – nga familja patriarkale (barinj), te familja trung (bujq), deri tek ajo bashkëshortore (industria) – që prej shumë kohësh është përgënjeshtuar nga kërkimet shkencore qoftë në fushën sociologjike, qoftë në fushën historike, por që ende është e pranishme në mendësinë e zakonshme.

Kërkimet e kryera nga *F. Engels*, një studiues me orientim kulturor të kundërt me atë të *Le Play*-it, përshkruajnë një rrugë që për disa aspekte është paralele, edhe pse përfundimet në të cilat ai arrin janë shumë më të ndryshme. Interpretimi i tij, të cilin e bëri të vetin dhe e përhapoi lëvizja marksiste, lexon kalimin ndërmjet dy mënyrave përbërëse të familjes që janë shumë të dallueshme nga njëra – tjetra (nga 'familja që varet nga pozicioni i nënës' te 'familja që varet nga pozicioni i babait') si njëri prej treguesve më domethënës të ndryshimit më të gjerë që përfshin gjithë jetesën shoqërore, që nga epoka e shoqërisë së egër, e cila ka qenë e karakterizuar nga një ekonomi gjuetie dhe mbledhjeje, deri tek ajo e shoqërisë civile, e cila ka qenë e karakterizuar nga zhvillimi fillestar i metalurgjisë që sjell për pasojë kalimin nga një 'pronë kolektive' primitive deri te një 'pronë private' më e zhvilluar. Në këtë kuadër shfaqja e institutit të martesës identifikohet si "forma e parë e luftës së klasave që shfaqet në historinë në të cilën mirëqenia dhe zhvillimi i një grupi janë përftuar nëpërmjet mjerimit dhe shtypjes së tjetrit" dhe, për pasojë, *Engels*-i përcakton zanafillën e pabarazisë shoqërore në familje, që për këtë arsye duhet të luftohet.

Edhe *E. Durkheim*, i konsideruar si themeluesi i shkencës sociologjike, duke lëvizur brenda një skeme historike edhe pse jo ende krejtësisht evolucioniste, i kushtoi një vëmendje të madhe familjes. Dy pika të reflektimit të tij duhen kujtuar: ligji i 'kontraktimit', marrëdhënia ndërmjet formimit shoqëror që identifikon si familje është, në zanafillën e vet, shumë e gjerë; reduktimi i përmasave të saj shoqëron përparimin e qytetërimit; identifikimi i industrializimit si vijë ndarëse që ndan 'traditën' nga 'modernizmi'. Prandaj kalimi në modernizëm është i shënuar nga përshpejtimi i trendit që e sheh të reduktohet gjerësinë dhe ndikimin shoqëror të familjes që humbet kështu në mënyrë progresive rolin e vet themelor të 'strukturës përbërëse' të shoqërisë.

Në një perspektivë të ngjashme vendoset kontributi i *F. Toennies*, i cili e fut dinamikën familje / shoqëri (politike) në një plan më të gjerë që e sheh të vepruarit shoqëror të njerëzve t'u japë shkas dy konteksteve të ndryshme: komunitetit ('gemeinschaft'), rezultat i ushtrimit të 'vullnetit natyror', të rrënjësor në një bashkëndarje

të vlerave dhe shoqërisë politike ('gesellschaft'), rezultat i ushtrimit të 'vullnetit racional', të themeluar mbi norma juridike që përcaktojnë sistemin e saj. Përfaqësuese kryesore e formës së parë është familja, ndërsa i së dytës është shteti.

Në këtë fazë, reflektimi mbi familjen arrin edhe në një lexim, shumë koherent me premisat e tij, në lidhje me rolin ekonomik që familja ka të konsideruar gjithmonë themelor, edhe pse në shoqëritë fshatare dhe artizanale ai shprehet nëpërmjet formës së unitetit të punës në bashkëpunim dhe në shoqëritë industriale si 'qendër konsumi', domethënë një vend në të cilin merren vendimet që kanë lidhje me blerjen e të mirave materiale.

Ardhja e shekullit XX do të sjellë ndryshime rrënjësore, të cilat do të ndikojnë thellë edhe mbi metodologjinë dhe mbi orientimet e shkencave shoqërore. Përkrah aspekteve metodologjike, dhe të paktën pjesërisht pasojës së tyre, duhet të vëmë në dukje shfaqjen e një perspektive të re me të cilën shikohet familja. Ajo nuk vëzhgohet thjesht si 'formë' e sistemit shoqëror, por fillon të jetë objekt i analizës, duke filluar nga aspektet e veçanta dhe specifike që janë të lidhura me mënyrat me të cilat anëtarët e saj jetojnë dhe krijojnë marrëdhënie ndërmjet tyre. Ky drejtim i ri i kërkimit do të arrijë në mënyrë të shpejtë që të propozojë teori të vërteta të përgjithshme të lidhjes shoqërore me pasqyrimet e rëndësishme mbi vetë nocionin e shoqërisë.

Në këtë kalim kontribuojnë shumë shkencat shoqërore klasike, në të cilat përfshijmë edhe historinë, sa edhe shkencat e reja. Ndër këto, për temën që na intereson, një rëndësi të veçantë ka antropologjia, që njeh te familja agentin e parë dhe më të rëndësishëm të shoqëzimit njerëzor dhe që për këtë arsye, përfaqëson një urë ndërmjet kërkimit sociologjik dhe atij historik / etnografik dhe më tej me kërkimin psiko - social. Në këtë perspektivë, në një pozicion qendror shfaqet detyra krijuese së cilës i përgjigjet familja qoftë nën aspektin e kujdesit (fëmijët kanë nevojë për ngrohtësi, ushqim, mbrojtje dhe dashuri) qoftë nën aspektin e kalimit nga një brez në tjetrin të bagazhit kulturor që karakterizon një komunitet (gjuha, vlerat, rregullat, besimet e vetë kulturës).

Për shkak të intimitetit të saj, familja i përmbush në përgjithësi këto kërkesa më mirë se cilido institucion tjetër shoqëror.

Edhe ndryshimi i perspektivës në të cilën veprojnë disiplinat tradicionale kontribuon në vëzhgimin e familjes nën një dritë të ndryshme.

Historia, e cila është bërë e vëmendshme ndaj aspekteve që deri atëherë ishin të kufizuara në kuadrin e asaj që përkufizohej si 'historia e vogël' ('petite histoire'), identifikon te familja një kuadër të privilegjuar nëpërmjet së cilës të kapet ndryshimi i kushtit të njeriut dhe në vetë ndryshimin jo më një moment tranzicioni drejt një sistemi të ri të pajisur me qëndrueshmëri, por si një karakter thelbësor dhe pozitiv i vetë modernizmit.

Familja merret gjithmonë e më pak parasysh si element karakterizues i strukturës së shoqërisë, për disa aspekte modeli të cilit duhet t'i referohet i gjithë organizimi shoqëror, ashtu siç ndodhte ende në vitet 700(shtatëqind), dhe një vëmendje gjithmonë e më e madhe i jepet marrëdhënieve ndërpersonale të vetë kuadrit familjar që e

humbet kështu interesin si 'institucion' për t'u konsideruar kryesisht 'kusht jetese'. Mënyrat e jetesës së përditshme brenda familjes duken më domethënëse sesa roli që institucionalisht familja ka në shoqëri, i cili duket gjithmonë e më i ridimensionuar dhe, të paktën sipas mendimit të shumë vetëve, është i destinuar që të shterojë.

Kjo nga njëra anë kontribuon që të lihen mënjane tezat që e tregojnë si të afërt (ose të nevojshëm) fundin e familjes, por nga ana tjetër cakton një ndarje të qartë ndërmjet dimensionit publik – të cilit i përket secili, në të cilin gëzon të drejta si individ dhe që prej këtij, për pasojë, familja si e tillë duhet të përjashtohet - dhe dimensionit privat të cilin në bazë të së drejtës i përket kuadri familjar. Duke u nisur nga kjo pikëpamje do të maten pasojat që zgjedhjet familjare kanë mbi aspektet kryesore të jetës në shoqëri që është në lëvizje dhe që rregullohet sipas parimeve nga të cilat familja duket se është e përjashtuar.

Historiografia e re kontribuon që ta konsolidojë këtë perspektivë, duke e marrë parasysh familjen jo më 'nga jashtë', si një prej institucioneve të jetës shoqërore, por 'nga brenda', si një mikrokozmos në të cilin vëmendja përqendrohet mbi rolin e komponentëve të vet të veçantë dhe mbi marrëdhëniet e tyre të ndërsjellta.

Rrymat e ndryshme që e marrin këtë perspektivë mund të përmbliken në dy grupe të mëdha, në varësi të referimit ndaj të dhënave sasiore, demografike në mënyrë të veçantë (perspektiva ekonomiste, e cila është mbizotëruese në zonën anglosaksone), ose ndaj aspekteve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet (historia e ndjenjave, e cila është mbizotëruese në Francë).

Në grupin e parë ajo që bie në dukje është shkolla e Kembrixhit (*Cambridge Group for the History of Population and Social Structure – Grupi i Kembrixhit* për Historinë e Popullsisë në Strukturën Shoqërore, eksponentët më të mëdhenj të të cilit janë *P. Laslett, E. Wrigley* dhe *R. Schofield*). Ajo nisur nga analiza e marrëdhënies ndërmjet familjes perëndimore dhe lindjes së kapitalizmit. Mënyra që është përdorur është ajo sasiore dhe mbështetet kryesisht mbi rezultatet e kërkimeve demografike. Një rezultat shumë domethënës i reflektimit, i cili ia heq pranueshmërinë 'ligjit të kontraktimit', të parashtruar nga E. Durkheim, ka të bëjë me familjen 'bashkëshortore', e cila identifikohet si forma karakteristike e familjes që është e pranishme në perëndim që nga zanafilla e saj mesjetare.

Grupit *P. Ariès, J.L. Flandrin, E. Shorter, L. Stone*, i detyrohen vepra të rëndësishme sinteze dhe kërkimi që shpesh janë të karakterizuara nga 'qasja e ndjenjave' ku në qendër të interesit është shpërbërja e sistemeve dhe e organizimit të familjes tradicionale dhe kalimi në familjen moderne në periudhën ndërmjet viteve 700 (shtatëqind) dhe 800 (tetëqind).

Dy janë imazhet e përbashkëta për të dyja rrymat. Familja tradicionale, e karakterizuar nga një depërtueshmëri ekstreme ndaj kushtëzimeve të jashtme dhe ndaj kontrolleve të komunitetit, e mbizotëruar në brendësinë e saj nga marrëdhënie respekti dhe autoritare, e përcaktuar nga patriarkati; themel i martesës janë kryesisht aspektet e natyrës ekonomike (prodhimi dhe riprodhimi, përcjellja e pronësisë nga njëri brez në tjetrin).

Martesa, ashtu sikurse edhe familja është e karakterizuar nga një nivel i ulët ndjenjash. Familja moderne, shpesh e emërtuar 'borgjeze', e karakterizuar nga modele referimi shumë të ndryshme, edhe pse jo gjithmonë të kundërta: liberale më shumë se patriarkale; e mbajtur së bashku nga dashuria ndërmjet bashkëshortëve sesa nga interesi ekonomik; thellësisht e interesuar dhe e lidhur me fëmijët; e lirë në mënyrën e shprehjes së seksualitetit. Ky model është i destinuar që të mbizotërojë mbi atë tradicional, sepse është koherent me vlerat e referimit të modernizmit, edhe pse kalimi nga njëri te tjetri është pashmangshmërisht gradual dhe i diferencuar në situatat e ndryshme historike dhe mjedisore.

Një qasje e tretë (*Anderson*), e merr emrin nga bërthama shoqërore së cilës i referohet ('household': grumbullim shtëpiak, i përcaktuar nga bashkëjetesa në të njëjtën banesë e një grupi me lidhje prindërore). Ajo propozon që të fusë në mënyrë më sistematike historinë e familjes në historinë e shoqërisë, duke u bërë një ndër kapitujt më të rëndësishëm të saj. Kështu, pra, nuk ekziston një 'histori e vetme e familjes', por aq histori sa janë edhe grupet shoqërore të marra parasysh (familja fshatare, familja e fazës fill-estare të industrializimit, familja punëtoare, në mënyrë të veçantë në fazat e para të industrializimit, etj).

Për këtë arsye, perspektiva e saj e kërkimit karakterizohet nga forma të eklektizmit, që pikërisht për këtë i bën të mundur që të ndriçojë aspekte të rëndësishme të fenomenit 'familje', të cilat përndryshe do të mbeteshin në hije.

Edhe evolucioni i kërkimit sociologjik është i karakterizuar nga zhvendosja e vëmendjes nga kuadri 'makro', për të cilin ishte kryesisht e interesuar deri atëherë, te një kuadër 'mikro'. Kësaj i kontribuon sigurisht pozicioni qendror që kanë marrë aspektet funksionale, që megjithatë edhe më përpara nuk kishin qenë krejtësisht të mangëta, që shpie në identifikimin e aspektit më të rëndësishëm të familjes në mënyrën se si vepron në brendësinë e saj.

T. Parsons përpunon referimin teorik mbi të cilin mbështetet teoria funksionaliste. Edhe ai e analizon familjen në raport me nevojat shoqërore që ajo përmbush dhe është i mendimit se familja e përbërë nga bërthama krijohet si përgjigje ndaj kërkesave të një shoqërie si ajo industriale që rekluton njerëz në bazë të karakteristikave të përfuturës dhe shkakton për këtë arsye një lëvizshmëri të fortë gjeografike dhe shoqërore.

Një temë që mund të konsiderohet 'kalimtare' ndërmjet fazës 'politike' dhe fazës 'funksionale' të kërkimit sociologjik mbi familjen është sigurisht ajo që ka të bëjë me strukturën e familjes dhe me raportin që krijojnë në të marrëdhënia bashkëshortore dhe lidhja farefisnore.

Sipas *Bott*-it, gradualisht me rritjen e industrializimit dhe të urbanizimit, afirmimi i familjes së përbërë nga bërthama sjell për pasojë lirin progresiv të lidhjes farefisnore, që në këtë mënyrë e humbet rëndësinë.

Perspektiva e përvijuar nga *Parsons* kontribuon në mënyrë domethënëse në zhvillimet e mëtejshme të kërkimit që do të ketë edhe ndikimin e fuqishëm të qasjes psikoanalitike të *S. Freud*-it, duke

Familja: një realitet që ngaherë e shoqëron njeriun.

qenë se detyrojnë marrjen e qëndrimit kundrejt çështjes së subjektit, që për disa duhet të mohohet në mënyrë rrënjësore dhe për disa të tjerë, në të kundërt, duhet të vihet përsëri në qendër të skenës.

Zhvillimi i parë është ai që shpie në strukturalizmin, një prej eksponentëve kryesorë të të cilit është *M. Foucault*. Për Foucault familja përkon me një 'pajisje' pushteti, të mbështetur mbi babanë, mamane dhe fëmijët, të karakterizuar nga 'të qenët ishullor' dhe nga 'heteromorfizmi' që e dallojnë nga mekanizmat e tjera të pushtetit. Pikërisht falë tij ka qenë e mundur që të përhapen praktikatat e kontrollit maltusian të lindjeve, u është bërë ballë shtytjeve populiste, janë bërë hapa vendimtarë drejt 'dhënies së një karakteri mjekësor' të seksit dhe 'psikiatrizimit' të formave të tij jogenitale.

I dyti shumë më i pasur, sepse është themeluar mbi një vizion pozitiv të përvojës njerëzore që njeh te familja një kusht të nevojshëm për zhvillimin e unit.

Që nga *Spiz*-i tek *Erikson*-i, deri te *Winnicott*-i, të gjitha studimet mbi patologjinë e unit, vënë në dukje se kushti i parë, në kuptimin logjik dhe kronologjik, në mënyrë që 'uni' të mund të krijohet, është se individi, personi, të jetë një "ti" për dikë. Dhe familja përfaqëson planin e parë dhe më të rëndësishëm në të cilin kjo gjë ndodh.

Unë nuk jam në boshllëk, nuk jam dikush që nuk ka bashkëlidhje dhe lidhje në situatën që më rrethon, por 'unë jam një ti', sepse ekziston dikush tjetër, me të cilin gjërat që bëj, them, mendoj, mund të ballafaqohen, të bashkëndahen, si edhe të 'miratohen'. Të jesh një 'ti' do të thotë të perceptosh një solidaritet bazë, përkatësinë ndaj dikujt. Historia jonë, historia e unit tonë, duhet të ruhet nga marrëdhënia me një apo më shumë unë, të cilët të jenë garantues (dëshmitarë të pajisur me kujtesë dhe me vetëdije për përparimin tonë). Për pasojë, është e nevojshme që rritja jonë si 'unë' të mbështetet gjithmonë mbi të qenit të njohur në mënyrë të qëndrueshme si një 'ti' nga një apo më shumë 'unë' domethënëse: 'ti'-ja me të cilin krijohet marrëdhënia jonë fillestare është 'uni' i prindërve tanë.

Erikson-i pohon se fëmija 'mëson të jetojë' në hapësirë dhe në kohë dhe, domethënë, në mënyrë të pashmangshme, në formën e hapësirës dhe të kohës që karakterizojnë kushtet e tij të jetesës, ndër të cilat një kuptim krejtësisht të veçantë e merr kultura. 'Ti-të domethënëse', dëshmitarë të pajisur me kujtesë dhe me vetëdije për përparimin tonë, dhe domethënë në një mënyrë absolutisht të veçantë indërit, përfaqësojnë për këtë arsye një kusht thelbësor në mënyrë që fëmija të mësojë.

Ky pozicion përfaqëson një pushim domethënëse të procesit të 'privatizimit' të përvojës familjare. Ndarja (pothuajse një frakturë) ndërmjet dimensionit publik (të arsyes dhe të moralit) dhe atij privat (i ndjenjave dhe i dëshirës) që për më shumë se një shekull ishte krijuar pothuajse si një apriori e padiskutueshme, që për shumë aspekte ishte vërtetuar nga Freud-i me diadën 'e pavetëdijshmja – superego-ja', gjen në këtë konceptim të ri dhe më të plotë të 'nxënies' arsyet për një ndryshim të prirjes, duke qenë se njihet fakti se sinergjitë ndërmjet aftësive të ndryshme të njeriut gjejnë një sitenzë të vetme të mundshme në shprehjen 'të mësosh të jetosh'.

Rritja e rëndësisë së kësaj perspektive është e dokumentuar nga lindja e një disipline të re kërkimi, 'Psikologjia shoqërore e familjes', një nga eksponentët më të rëndësishëm të së cilës përfaqësohet nga *E. Scabini*. Kjo qasje e re shkencore synon të nxjerrë në dritë marrëdhëniet ndërmjet dinamikave të brendshme të familjes, format e saj dhe rolet shoqërore që i atribuohen asaj. Një rëndësi të madhe ka edhe qëllimi i dukshëm për ta lexuar përsëri familjen si 'subjekt shoqëror', qëllim që mbart në vetvete kërkesën për të mos e ndarë momentin e kërkimit dhe të reflektimit nga ai i ndërhyrjes operative.

Në një plan tjetër, sociologjik më shumë se psiko-social, një kontribut po aq të rëndësishëm në të njëjtin drejtim është sjellë nga *PP. Donati*, i cili e përballon reflektimin mbi familjen duke u nisur nga nocioni i 'sociologjisë së marrëdhënies'. Në këtë perspektivë, shoqëria nuk shfaqet e karakterizuar vetëm (ose kryesisht) nga aspektet e saj funksionale (ndër të cilat hahen për vendin e parë ato politiko – administrative dhe ato ekonomike). Këto aspekte nuk janë në gjendje që të shpjegojnë dimensionin e 'krijueshmërisë' që përfaqëson gjithashtu një element thelbësor të bashkëjetesës në shoqëri dhe që është shprehje e cilësisë dhe e mënyrave të marrëdhënies ndërpersonale që vendosen në vetë shoqërinë. Kjo perspektivë e sjell përsëri në plan të parë familjen, jo vetëm si vendi i ndjenjave, i intimitetit, i aspektit privat, por edhe si një tërësi marrëdhëniesh që, ligjërisht, përbëjnë një 'kontekst', i cili është në gjendje që të parashtrijë norma dhe të përcaktojë kushte që shënojnë tërësinë e sistemit shoqëror jo vetëm në aspektet e veta vlerore / kulturore, por edhe në format e saj konkrete (të cilat, pra, ndikojnë mbi kohën dhe mbi hapësirën).

Një vëzhgim i fundit, i cili lidhet me vlerësimet me të cilat hapet ky kapitull.

Pothuajse dy shekuj më parë, legjislati i shtetit liberal që po lindte, që ishte i prirur të mbronte të drejtat e individit, synonte që t'ia hiqte familjes zotërimin e të drejtave juridike specifike. Në Itali, për shembull, tashmë Kodi Civil i shpallur në vitin 1865, - i cili ishte i prirë që të konfirmonte të drejtën ekskluzive të shtetit për të bërë ligje mbi martesën – duke futur normat që kanë të bëjnë me familjen në titullin V, i cili i kushtohet familjes, vepron në këtë drejtim dhe vëmendja e ligjvënësit duket se i drejtohet kryesisht përvijimit nga njëra anë të të drejtave dhe të detyrave të bashkëshortëve, ndërsa nga ana tjetër kërkesat dhe detyrimet për të lidhur ose për të zgjidhur martesën.

Edhe Kisha Katolike, e cila ka qenë gjithmonë shumë e vëmendshme ndaj gjithçkaje që ka të bëjë me familjen, mbasi e humbi betejën me shtetin për kompetencën juridike mbi martesën, edhe pse nuk ka reshtur së theksuari vlerën shoqërore të familjes dhe së mbrojturi traditën e familjes së krishterë, e zhvendos vëmendjen e vet për familjen mbi aspekte të tjera, ndër të cilat mbi natyrën sakramentore të martesës (të krahasohet enciklika 'Arcanum divinae sapientiae' e shpallur nga Leone XIII në vitin 1880) dhe, mbi të gjitha, mbi sjelljen morale të bashkëshortëve.

Por mbas më shumë se një shekulli distancë mund të themi se, për studiuesit e çdo prirjeje, familja vazhdon të përfaqësojë një

mënyrë specifike të bashkimit shoqëror, atë qendrore në të gjitha format e makroagregatëve shoqërore të njohura deri më tani. Edhe kush e quan familjen të kapërcyer, nuk i shmanget këtij gjykimi: madje mendon se familja duhet të kapërcehet pikërisht sepse është qendrore në sistemin shoqëror që, me afirmimin e modernizmit, e karakterizuar nga një konceptim me karakter universal i marrëdhënieve shoqërore, kërkon një ndryshim rrënjësor edhe në marrëdhëniet ndërpersonale. Tezë kjo që, në qoftë se shpëhet në ekstrem, bën që të përputhet afirmimi i plotë i modernizmit me zhdukjen e familjes si institucion i rëndësishëm nga pikëpamja shoqërore (publik), të cilit i mbetet vetëm një funksion me natyrë lojërash / ndjenjash (privat).

Kësaj teze i kontribuoi edhe afirmimi progresiv i familjes borgjeze që, edhe pse duke u nisur nga një situatë pakice nga pikëpamja numerike, nga gjysma e viteve Tetëqind dhe për shumë breza do të përfaqësojë modelin tërheqës qoftë nën profilin kulturor që, për shumë aspekte, për sisteme konkrete që jeta familjare do të marrë. Ajo në të vërtetë nuk identifikon familjen tipike të një shtrese shoqërore, klasën e mesme, por përvijon një model të karakterizuar nga sjellje vendosmërisht novatore: pririjen drejt martesave me dashuri, kërkimin e intimitetit familjar, rëndësinë që i jepet shtëpisë dhe hapësirave private të banesës. Gruaja, bashkëshorte dhe nënë shembullore, është figura më e fuqishme mbrojtëse e këtij ishulli të lumtur të fshehur nga sytë e jashtëm nga muret e shtëpisë; burri, baba dhe punëtor i ndershëm, është shtylla mbajtëse, fëmijët edukohen dhe përkëdhelen si asnjëherë në të kaluarën.

Por, ashtu sikurse e dimë të gjithë, ky konceptim shumë i idealizuar, nuk ka qëndruar shumë mbi planin teorik sa, dhe edhe më shumë, mbi atë konkret të jetës.

Kontestimi ndaj familjes në mënyrë të veçantë ndaj formës së saj 'borgjeze', përfaqëson njërin prej aspekteve që karakterizojnë 'revolucionin kulturor' që, ndërmjet fundit të viteve '60 dhe viteve të mëpasëm '70, ka prekur në mënyrë të veçantë vendet më të zhvilluara dhe më pas, në formë kaskade, është duke përfshirë një numër gjithmonë e më të madh vendesh.

Përballë krizës që kanë bërë të shfaqet kalimi i mijëvjeçarit dhe fundi i ideologjive, në mënyrë të veçantë në formën e një nihilizmi të përhapur, prepotente bëhet kërkesa për të rifituar nocionin e familjes për të kuptuar problemet që, edhe por jo vetëm nën profilin edukativ, përfshijnë brezat e rinj. Dhe kjo është pa dyshim shenja që familja vazhdon të përfaqësojë një referim thelbësor për njeriun që ka për qëllim të jetojë 'i bashkëshoqëruar'.

PËRGJEGJËSIA PRINDËRORE DHE FAMILJA

Familja përfaqëson situatën e parë dhe më të rëndësishme në të cilën individit i duhet të shprehë subjektivitetin e vet. Pikëpamja me të cilën secili e vështron familjen është pra ngushtësisht e lid-

hur me idenë e njeriut që secili është, në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme, mbartës. Ballafaqimi kulturor dhe politik i ngjeshur që ka pasur (dhe që vazhdon të ketë) si objekt familjen ka pasur si rezultat konfirmimi që familja vazhdon të ketë një rol të vetin, të pazëvendësueshëm, duke qenë se në të gjejnë vend dhe përgjigje disa kërkesa të pashmangshme të njeriut, edhe pse vazhdojnë të ekzistojnë dallime të mëdha në identifikimin e këtij roli. Eklipsi, edhe i pjesshëm, i vëmendjes ndaj rolit publik (politik) të familjes ka dhënë sigurisht një kontribut pozitiv, duke nxjerrë në dritë faktin se sa i ngushtë është raporti ndërmjet vetëdijën personale dhe konceptimit të familjes, por në qenien e saj si zgjedhje 'ekskluzive' mund të gjenden shumë prej arsyeve që shpjegojnë brishtësinë që sot është shumë e pranishme në kushtet familjare.

Një rol i parë i padiskutueshëm është i lidhur me marrëdhënien e ngushtë ndërpersonale që ekziston ndërmjet burrit dhe gruas (bashkëshortësi – martesë) që duket se është pika e burimit (bërthama) e familjes. Përkrah këtij vendoset, edhe pse hera – herës në një pozicion të dallueshëm, 'brezi' dhe, në një pozicion sot shumë të mënjanuar, "farefisnia". Kjo bërthamë marrëdhëniesh (bashkëshortësia, brezi, farefisnia) paraqitet sigurisht me karakteristika të ndikuara fuqimisht nga faktorët e shumtë të vetë kontekstit socio – kulturor në të cilin ata vendosen; nga kjo e ka zanafillën nevoja për t'u dhënë një renditje mënyrave të ndryshme me anën e të cilave familja merr formë konkretisht.

Propozojmë këtu dy prej taksonomive të përpunuara më të përhapura.

E para, e shkollës së Kembrixhit, merr si kriter të parë renditës të dhënë sasiore, edhe pse, qoftë edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, 'bashkëshortësia' mbetet i pranishëm si element i nevojshëm për të dalluar format e ndryshme të familjes:

- Bërthamore, e formuar nga një njësi e vetme bashkëshortore;
- E zgjeruar, e formuar nga një njësi e vetme bashkëshortore dhe nga një apo më shumë të afërm bashkëjetues;
- E shumëfishtë, e formuar nga dy apo më shumë njësi bashkëshortore;
- Pa strukturë bashkëshortore, pa një njësi bashkëshortore (në të ka vetëm persona që bashkëjetojnë);
- E vetmuar, e formuar nga një person i vetëm.

E dyta, që merr haptazi si kriter renditës marrëdhënien bashkëshortore, i dallon format e ndryshme të familjes si më poshtë vijojnë:

- Bashkëshortore, e përbërë nga prindi / prindërit dhe nga fëmijët e tij / të tyre;
 - monogamike, kur në të ka vetëm dy prindër (më e përhapura, sidomos në zonat urbane);
 - poligjinike, kur në të ka vetëm një baba, pa dallim ndërmjet prindit femër natyror dhe grave të tjera që i përkasin grupit të vet prindëror;
 - poliandrike, kur në të ka një nën të vetme, pa dallim ndërmjet prindit mashkull natyror dhe burrave të tjerë që i përkasin grupit të vet prindëror;

- o poliginandrike, ose e martesës në grup, kur në të ka disa nëna dhe baballarë që bashkëjetojnë;
- Njëgakëse, sinonim i familjes së zgjeruar, të përbërë nga prindërit, nga familjet e tyre të prejdardhjes dhe nga pasardhësit e tyre;
- Njëprindërore, e përbërë nga një prind i vetëm dhe nga fëmijët e tij, të lindur apo të birësuar.

Marrja si model referimi e familjes bërthamore, domethënë e familjes së përbërë nga dy prindër me fëmijët e tyre, na ndihmon të kuptojmë se cilat janë lidhjet 'e forta' që ekzistojnë ndërmjet individëve që e përbëjnë atë. Familja bërthamore duket për shumicën, edhe të studiuesve, më e mira ndër alternativat e ndryshme, duke qenë se është në gjendje që t'u sigurojë më mirë anëtarëve të brezave të mëpasëm mbështetjen e duhur emocionale, si edhe t'i ndihmojë ata që të gjejnë rrugët e tyre. Për këtë arsye, edhe duke u njohur si tipike e shoqërive të karakterizuara nga lëvizshmëria relative, ndër të cilat sigurisht përfshihen shoqëritë e industrializuara, është konsideruar përgjithësisht njësia – bazë edhe në llojet e tjera të familjes, pavarësisht nga forma specifike që ka marrë në kontekstet e ndryshme shoqërore. Edhe pse modeli i familjes bërthamore duket më i miri, nuk mund të mos mbajmë parasysh që krizat familjare (ndarjet dhe divorcet) karakterizojnë tashmë pjesën më të madhe të popullatave dhe për këtë arsye shumë fëmijë nuk mund të përfitojnë nga avantazhet që jep përkatësia në një familje me model bërthamor ose ndodhen në kushtet kur u duhet të përballojnë probleme të vështira përshtatjeje me kontekstet e reja të jetës.

Ky kuadër, shumë problematik dhe i diskutuar, mund të kuptohet më mirë kur kalohet në shqyrtimin e mënyrave me të cilat përjetohen sot lidhjet që i përkasin familjes 'së zgjeruar', domethënë fenomenit të farefisnisë. Ato duken sot shumë të dobësuar, shpesh të lëna pasdore, ka të ngjarë edhe si pasojë e dobësimit të funksionit 'publik' që i njihet sot familjes. E rëndësishme është që të dalë në dukje pjesa që, në dobësimin e strukturës farefisnore, ka pasur emancipimin femëror që përfshin, përkrah pavarësisë ekonomike, edhe një shpirt imitues të sjelljes seksuale mashkullore dhe nivelon dallimet ndërmjet burrit dhe gruas në zakone, në veshje, në raportin ndërmjet jetës private (shtëpisë) dhe jetës publike. Një pasojë e mëtejshme është se martesë e humbet detyrën e bërjes së bashkimit seksual ekskluziv për një çift.

Një kontribut i rëndësishëm në përfundimin e efekteve të këtyre ndryshimeve (shumë më pak sesa në lindjen e tyre) shpie sigurisht në faktorë të ndryshëm, ndër të cilët, sigurisht, përhapja e ideologjive që janë kundër familjes, veçanërisht aktive në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, si edhe rritja në shoqëri me struktura 'edukuese' që veprojnë jashtë kufijve të familjes, edhe të asaj të zgjeruar.

Shtimi i shërbimeve sociale dhe e shkollave përfaqëson në të njëjtën kohë një shkak dhe një pasojë të këtyre ndryshimeve: pasojë, mbasi mënyrat e reja me anën e së cilave strukturohet sistemi prodhues e bëjnë më të vështirë mbajtjen e një pranie shtëpiake, aspekt mbi të cilin luan një rol sigurisht të rëndësishëm edhe lirimi i lidhjeve farefisnore; shkak, mbasi fusin stile sjelljeje dhe mënyra në organizimin e kohës, në të cilat 'shtëpia' merr një rol të dorës së dytë.

Një peshë të veçantë në këtë proces e ka shkolla, e pranishme në shoqëritë perëndimore që nga fillimi i shekullit XVII që, duke filluar nga gjysma e dytë e viteve '900, i rrit fuqimisht hapësirat e veta sasiore (më shumë orë, për më shumë ditë, për më shumë vjet) dhe ato cilësore (nuk parashtron më objektiva që kanë të bëjnë vetëm me arsimin, por edhe me shoqërimin dhe me edukimin) duke u bërë një hapësirë jete, e cila tendencialisht nuk është më vetëm plotësuese, por edhe zëvendësuese e familjes. Përkrah shkollës, forma të tjera institucionale zhvillohen, me synimin që ta shoqërojnë familjen në detyrat e saj, duke marrë forma të ndryshme, në varësi të kushteve konkrete në të cilat duhet të veprojnë, por gjithmonë duke iu referuar një modeli operativ më antagonist sesa plotësues i kushteve të tjera në të cilat fëmija (por më pas duhet të themi i riu) jeton. Përvijohet në këtë mënyrë një sistem, mbartës jo më i objektivave specifike (për shembull, i ruajtjes, kujdesit, asistencës, arsimit, edukimit, etj.), por që është i prirur t'u përgjigjet të gjitha këtyre nevojave, me objektivin e deklaruar të zvogëlimit të dallimeve ndërmjet individëve të veçantë, në mënyrë të veçantë përsa u përket atyre që e kanë zanafillën në kontekstin shoqëror.

Kjo dinamikë ka karakterizuar jetën e dy / tre brezave, duke kontribuar që të përshpejtohej në mënyrë domethënëse procesi i mënjanimi të familjes si kontekst jete. Ajo është shoqëruar, dhe favorizuar, përveçse nga lirimi i lidhjeve të farefisnisë, edhe nga përhapja e modelit të 'fëmijës së vetëm', që në të vërtetë ka hequr nga dimensionin familjar kushtin e 'vëllazërisë' – përvojë e bashkëjetesës ndërmjet diversitetit të pamposhtshëm të identiteteve dhe mundësisë së bashkëjetesës mbasi janë fëmijët e të njëjtit baba – duke ndikuar thellësisht edhe mbi mënyrat cilësore dhe sasiore me të cilat është e pranishme 'farefisnia'. Kështu, pra. Nuk duhet të habisë fakti që aspektet që kanë të bëjnë me lidhjen bashkëshortore brenda një 'konteksti të rregullt' të dobësuar shumë, marrin një emfazë të panjohur ndonjëherë më përpara dhe duken në një masë të madhe të mbizotëruara nga aspektet psikologjike dhe marrëdhënia e çiftit duket e dallueshme nga marrëdhënia prindërore që përjetohet kryesisht si marrëdhënie ndërmjet njërit prind në veçanti dhe të birit. Kjo sjell pasojë shumë të rënda nën profilin edukativ: fëmija, në të vërtetë, që kërkon dhe që do të gjejë në kontekstin e tij kritere dhe kuptime për të jetuar, mbështetet te një i rritur – udhërrëfyesin në këtë ecje, pa të cilin fëmija do të humbiste – krejtësisht i vetëvënë në qendër dhe që emfazizon kështu aspektet egocentriste që karakterizojnë personalitetin e fëmijës në dëm të atyre aspekteve të marrëdhënieve dhe të kujdesit ndaj të tjerëve, mbartës i të cilëve është edhe fëmija.

Këto probleme, të cilat janë të lidhura me edukimin, që lenë shenja të thella në shoqërinë që po krijohet duke nisur që nga fillimi i mijëvjeçarit të ri, duhet të njihen në natyrën e tyre dhe të përballohen me vendosmëri. Kjo sjell për pasojë dy zgjedhje, njëra metode dhe tjetra përmbajtjeje.

E para ka të bëjë me mënyrën me të cilën duhet të merren parasysh marrëdhëniet që përbëjnë familjen dhe që familja nga ana e vet mban me kontekstin shoqëror në të cilin jeton. Ato, dhe domethënë problemet që i karakterizojnë, nuk mund të jenë objekt i një reflektimi abstrakt, nga ku të nxirren zgjedhjet teorikisht koherente, të

cilat duhet të 'aplikohen' pastaj në realitet por duhet të kapen në dinamikat e tyre konkrete, brenda kushteve të vetë shoqërisë në të cilin ndodhin, si pjesë thelbësore e një sistemi shoqëror kompleks, i cili të jetë në gjendje që të ruajë një ekuilibër ndërmjet nevojave të ndryshme. Dhe veçanërisht të rëndësishme, për temën që ju propozojmë, janë: puna, edukimi, liria vetjake, detyrimet shoqërore që, meqenëse kanë të bëjnë edhe me organizimin konkret të shoqërisë, janë sigurisht probleme edhe të një natyre 'politike'.

E dyta ka të bëjë me pikën qendrore të reflektimit që duhet të jetë familja si konteksti i jetës. Dobësimi progresiv i vëmendjes ndaj këtij aspekti ka sjellë një mungesë ekuilibri në rritje ndërmjet marrëdhënies së çiftit dhe krijueshmërisë që shfaqen gjithmonë e më shumë të dalluara. Dallimi ndërmjet familjes dhe marrëdhënies bashkëshortore (që është themeli i saj) zbehet dhe, për pasojë, në marrëdhënie mbizotëron çifti të drejta – detyra, që ka prirjen të dalë përmbi çiftin unë – ti, zanafillën dhe ushqimin e jetës familjare. Futja e divorcit si mundësi dhe mbi të gjitha zgjerimi i praktikimit të tij e vënë shumë mirë në dukje këtë tipar të pranishëm në gjendjen familjare. Dinamikat, jo vetëm të marrëdhënieve, që shfaqen në momentin e divorcit, por që me sa duket bëjnë pjesë që më përpara në jetën e bashkëshortëve, janë jashtëzakonisht domethënëse mbi të gjitha përsa i përket 'të qenit prind' që nuk shikohet më si përgjegjësi e përbashkët (e çiftit) por si përgjegjësi e secilit prind kundrejt fëmijës / fëmijëve.

Kjo situatë parashtron probleme që kanë zgjidhje jo të thjeshta, në mënyrë të veçantë ato që kanë të bëjnë me edukimin, duke qenë se është në kundërshtim fuqimisht me një të dhënë që është mbledhur vazhdimisht nga kërkimi: familja vazhdon të jetë institucioni kryesor i shoqërizimit parësor të brezave të rinj. Në të fëmija njih një 'marrëdhënie rregulluese' (atë me prindërit, në mënyrë të veçantë me nënën gjatë fazës së parë të jetës) dhe një 'burim njohjeje', duke qenë se gjuha, vlerat, rregullat, besimet që i përkasin kulturës së tyre, merren si të vetat, nga fëmija si një e dhënë, nga adoleshenti dhe nga i riu si një hipotezë që duhet të verifikohet në takimin e tij me përgjegjësinë e jetës. Fakti që, në shoqërinë moderne, shumë prej këtyre funksioneve shoqërizuese janë marrë nga institucione të tjera, ndër të cilat një peshë të rëndësishme, përkrah shkollës, ka sot sistemi i mediave, nuk e ka ndryshuar nevojën që ka fëmija për të njohur rrënjën nga e cila e ka prejardhjen dhe që kështu, pra, gjatë gjithë jetës së tij do të mbetet një referim i pashmangshëm.

Një element i mëtejshëm dhe i dallueshëm që vazhdon të jetë i pranishëm është nevoja e fëmijëve për përkujdesje dhe për ushqim, por sidomos për ngrohtësi, mbrojtje dhe dashuri. Familja, për shkak të intimitetit të saj, i përmbush në përgjithësi këto nevoja më mirë se çdo institucion tjetër shoqëror.

"Sa më shumë fëmija e percepton vlerën e vet, aq më shumë ai lëshohet drejt botës për ta përdorur atë që është". Fëmijët e kuptojnë vlerën e vetvetes nga një rrethanë shumë e përpiktë: marrëdhënia e përkujdesjes brenda së cilës ata ndodhen. Një marrëdhënie përkujdesjeje që sigurisht ndodh para së gjithash në familje, edhe pse shkolla ka në këtë pikë një përgjegjësi domethënëse.

Të kthyerit në një bashkëjetesë më harmonike ndërmjet dy aspekteve që përbëjnë zembrën e familjes kërkon që të rimerret një reflektim mbi lidhjen që bashkon ndërmjet tyre marrëdhëniet e ndryshme ndërsujektive që janë të pranishme në familje në mënyrë që të arrihet të kuptohet dhe të ripërcaktohet ai kuadër i jetës që e quajmë familje në mënyrë të përshtatshme me kushtet e sotme të jetesës. Kjo sjell për pasojë, ashtu sikurse kemi kujtuar më përpara, gatishmërinë për të futur në lojë konceptimin e njeriut të cilit i referohemi: marrëdhëniet, në të vërtetë, nuk janë të kuptueshme pa iu referuar subjekteve të cilët i menaxhojnë ato dhe ato nuk duhet të vëzhgohen vetëm, ose kryesisht, duke u nisur nga dimensionet psikologjik ose si pjesë e një problemi abstrakt antropologjik, por brenda aspekteve konkrete dhe kuadrove në të cilat ato përfshihen, në rastin tonë individë që jetojnë në të njëjtën familje.

Për t'iu përgjigjur pyetjes se çfarë përfaqëson familja sot për personat që bëjnë pjesë në të, është e nevojshme t'u kthehemi dy aspekteve themelore që e përcaktojnë atë: marrëdhënia e çiftit dhe marrëdhënia prindërore. Marrëdhënia e çiftit që lidh një burrë dhe një grua shfaqet gjithmonë si bërthama themeluese e familjes dhe, si e tillë, përcakton kufijtë dhe kushtet e ekzistencës së saj. Sot kjo marrëdhënie duket se krijohet kryesisht mbi 'zembrën', aspektin e lidhjes që i përket dimensionit të ndjenjës, dhe, pikërisht për këtë nga njëra anë shumë e fortë dhe, në të njëjtën kohë, shumë e brishtë. Ndërsa përfshihen në sfondin 'përgjegjësi' dhe 'vlera', aspekte që dikur përcaktoreshin si 'detyrë'. Kështu pra, lidhja përfaqëson një investim të madh për secilin prej partnerëve, jo lehtësisht i gatshëm për transaksionet mbi aspektet e marrëdhënieve që janë shprehje e saj dhe domethënë shumë i ekspozuar ndaj pasojave të lindura nga kontradiktat që janë gjithmonë të pranishme në çdo individualitet.

Po aq ekskluzive duket se është edhe marrëdhënia prind – fëmijë. Por ndërsa për fëmijën marrëdhënia është e përqendruar në mënyrë instiktive mbi çiftin që e ka lindur, për prindin e marrë në veçanti ndihet si një përgjegjësi shumë e fortë për të cilën secili prind duhet të japë llogari në mënyrë individuale.

Kufiri, mbi të gjitha edukativ, i kësaj mënyre të të qenit prind, shfaqet dukshëm nëse mbahet parasysh që ajo përfaqëson paradigmen, prej nga fillon të krijohet hapësira e organizuar që mbështet dhe orienton rritjen. Një kufi i tillë vihet në dukje më tej nga mungesa e shpeshtë e një shoqërie vëllazërore së cilës i duhet referuar, përveç mosekzistencës thelbësore të marrëdhënieve prindërore 'aktive'.

Familja është vendi i privilegjuar në të cilin mësohen dhe kultivohen marrëdhëniet, ku njerëzit krijojnë përvojën e përkatësisë, ku ndërtohen vlerat që i japin thelbin individualitetit të secilit prej nesh. Qëndrueshmëria e lidhjeve familjare brenda ngjarjeve të përditshme u bën të mundur fëmijëve një rritje më harmonike, sepse di të ofrojë referime të forta për rritjen e tyre dhe për zhvillimin e personalitetit të tyre në masën në të cilën i përgjigjet nevojës së fëmijës për të qenë i shoqëruar dhe i mbështetur, dhe më përpara se të ketë një udhë e shënjuar që t'i bëjë të mundur të ecë me shpejtësi të paktën gjatë viteve të para të jetës së vet.

Kjo gjithmonë supozohet nga praktikatat e jetës së familjes dhe për

Kontekste formale të nxënies dhe familja: një marrëdhënie që duhet ndërtuar

këtë ka shumë rëndësi që fëmijët ta ndiejnë që kjo marrëdhënie e fortë është me çiftin e prindërve edhe atëherë kur ndodh më vete me secilin prej tyre. Çifti prindëror propozohet kështu si shprehje e detyrës themelore të përcjelljes së jetës jo vetëm si një fakt biologjik, por edhe në aspektet e saj kulturore, domethënë ato të vlerave dhe të kuptimit.

Në mënyrë që aventura e 'të qenit një familje' të mund të zhvillohet në të gjitha potencialet e veta, është shumë e rëndësishme për këtë besimi i ndërsjelltë i çiftit, por ky nuk është i mjaftueshëm: në qoftë se ajo mbetet e izoluar, në qoftë se nuk hapet ndaj marrëdhënieve, të cilat janë mundësi mbështetjeje të ndërsjelltë, nuk krijohen kushtet optimale për rritjen e fëmijëve. Dhe për këtë, për sa kemi thënë në lidhje me mënyrën me të cilën fëmijët mësojnë, është e nevojshme të krijohet përvojë.

Por në kontekstin e sotëm është e lehtë që prindërit të jenë pak të sigurt jo vetëm mbi mënyrën me të cilën ta përballojnë detyrën e tyre, por edhe mbi përmbajtjen e vetë asaj, nga e cila nuk mund të hiqet dorë. Një burim i rëndësishëm për t'iu përgjigjur kësaj pasigurie është sigurisht kthimi te përvoja e atyre vetë si fëmijë dhe se si ajo është zhvilluar kur gjendjes sonë si fëmijë i është shtuar edhe ajo si prind: por nuk është e mjaftueshme, edhe sepse mund të ndodhë që të merret një stil edukues kryesisht si reagim ndaj një përjetimi si fëmijë, i cili nuk është pozitiv. Frika e kryerjes së gabimeve dhe ndjenjat e fajit rrezikojnë kështu që t'i dërrmojnë energjitë tona dhe kjo ndodh në mënyrë të pashmangshme në qoftë se nuk jemi të gatshëm për të bërë një ndryshim vetjak, i cili mund të fillojë vetëm përballë zbulimit të një pozitiviteti të pranishëm, për shembull, te vetë fëmijët.

Në këtë pjesë dy janë çështjet thelbësore që familja, e gjithë familja, të pranojë të jetë e shoqëruar; që prindërit të dinë të marrin përsipër një përgjegjësi të drejtpërdrejtë kundrejt institucioneve të tjera formuese në të cilat fëmija i vet është i pranishëm. Kjo ndodh kur hapësira e jetës së familjes shënohet nga pikëpamja materiale dhe e ndjenjave edhe nga prani të tjera që krijohen duke u nisur nga i njëjti kriter (çifti + brezi) dhe kur prindërit bëhen të gatshëm për ballafaqimin me ata që, persona apo institucione, kanë të bëjnë në mënyrë të qëndrueshme me fëmijët e vet. Kështu pra, kjo sjell për pasojë nevojën për të përcaktuar marrëdhënie të rëndësishme, të qarta dhe të fuqishme, me institucionet, në rradhë të parë me shkollën, së cilës sot shoqëria i beson detyrën e përfaqësimit të një 'konteksti domethënës' për jetën e brezave të rinj.

Në këtë perspektivë shfaqet roli specifik i prindërve, të cilët janë zotëruarit e përgjegjësive që kanë të bëjnë me jetën familjare dhe, në mënyrë të veçantë, 'kujdestarët' e fëmijëve të tyre. Në këto, ashtu sikurse në aspekte të tjera që karakterizojnë sot gjendjen e familjes, mund të gjejmë një rast për të penguar që 'thjeshtëzimi' i ndërthurjes së marrëdhënieve që e ka përfshirë, dhe në mënyrë të veçantë, të qenit e saj e kufizuar në kuadrin e 'privatit', shkatërron një pjesë të madhe të potencialeve të saj edukuese. Ushtrimi i një përgjegjësie të drejtpërdrejtë në marrëdhënien me institucionet e tjera në të cilat është i përfshirë fëmija i vet, është sot një kusht i nevojshëm që dimensionin familjar të kontribuojë në mënyrë do-

methënëse në rritjen intelektuale të fëmijës.

Në këto marrëdhënie prindi duhet të futet i vetëdijshëm se është mbartës i të drejtave, duke qenë mbartës i një përgjegjësie parësore kundrejt fëmijës së vet. Kështu pra, ushtrimi i së drejtës përputhet me riafirmimin e kësaj përgjegjësie, dhe ndoshta për këtë arsye sot shumë prindër pa problem i delegojnë detyrat e veta edukuese.

Kjo sjell për pasojë që të dihet të dallohet çfarë ka të bëjë me marrëdhënien shkollë – familje nga çfarë ka të bëjë me marrëdhënien prindër – mësues. Në rastin e parë duhet të lidhin marrëdhënie dy kontekste jete që janë thellësisht të ndryshëm nga njeri – tjetri. Asnjëri prej këtyre të dyve nuk mund të mos marrë parasysh ekzistencën e tjetrit, edhe vetëm nga pikëpamja praktike e organizimit të kohëve të jetës, por mbi të gjitha askush prej këtyre të dyve nuk mund të mos mbajë parasysh që i biri /nxënësi është i pranishëm në të dyja kontekstet. Objekt i kësaj marrëdhënieje është gjithmonë kryesisht përcaktimi i marrëdhënieve të ndërsjellta përsa i përket hapësirës dhe kohës dhe, në disa raste, edhe përsa i përket objektivave të arsimit dhe të edukimit. Kur ky pozicion harrohet, lind ose mosinteresimi, ose një konfliktualitet i fshehur.

Marrëdhënia prindër – mësues ka një tjetër natyrë. Bëhet fjalë për persona që lidhin marrëdhënie në mënyrë të qëllimshme dhe objekti i marrëdhënies së tyre është domosdoshmërisht e përbashkëta që ata kanë: biri /nxënësi; një vëmendje që unë kam si prind dhe që u kërkoj mësuesve që të kenë për tim bir; njohja e aspekteve të panjohura të birit / nxënësit, që mund të jetë sa e prindit aq edhe e mësuesit, mundësia për të bashkëpunuar duke pasur si synim një objekt. Kjo gjë ndonjëherë konsiderohet nga mësuesi si një akt i padrejtë nga ana e prindit, edhe sepse shpesh prindërit nuk kanë një perceptim të përshtatshëm të kushteve efektive në të cilat shkollës i duhet të veprojë.

Përtej formave, që qoftë prindërit, qoftë mësuesit mundën gjithmonë të mësojnë, është shumë e rëndësishme që të lindë nga marrëdhënia prindër – mësues një aleancë, e cila të ketë si objekt organizimi shoqëror jep. Në të vërtetë, tepër shpesh kjo nevojë, e cila ka një rëndësi jetësore për të ardhmen jo vetëm të individëve të veçantë, u propozohet edhe të gjitha nevojave të tjera që janë të pranishme në kontekstin shoqëror.

Kriza edukative e sotme është pasoja e pashmangshme e kësaj.

KONTEKSTE FORMALE TË NXËNIES DHE FAMILJA: NJË MARRËDHËNIE QË DUHET NDËRTUAR

Detyrë e fëmijës është të nderojë babanë dhe nënën, por detyrë e prindit është të nderojë fëmijën. Të besojë deri në fund tek ai. Në qoftë se nuk e bën prindi këtë, kush do ta bëjë? Prindi mbart këtë shenjë madhështie të fëmijës, të besojë te fëmija i vet deri në fund,

edhe përballë vështirësive më të mëdha të botës.

Edhe kundrejt shkollës kjo karakteristikë e prindit duhet të mbështetet, por kjo nuk do të thotë që nuk ka forma të tjera në të cilat përgjegjësia e prindit kundrejt shkollës duhet të shfaqet në mënyrë që të bëjë të mundur konkretisht ekzistencën e asaj 'aleance edukative' që kemi parë të jetë sot kaq e nevojshme.

Në qoftë se detyra e prindit është të garantojë frekuentimin e fëmijës në shkollë, dhe detyrë e mësuesit është të organizojë dhe të japë të gjitha mjetet dhe kushtet me qëllim që të realizohet suksesi shkollor i fëmijës, nuk mund të harrojmë që rezultati, pozitiv ose negativ, në të dyja frontet, nuk i atribuohet asnjëherë vetëm mësuesit ose prindit.

Fëmija / i riu kur ndërmer përvojën shkollore (dhe jo vetëm këtë) fut në lojë tri kërkesa, tre nevoja themelore që mund të identifikohen si më poshtë vijon:

- 'afirmimi i vetvetes' (ose vetëvendosja), që është pjesë e procesit të ndërtimit të identitetit të një personi;
- 'ndjenja e kompetencës', që në shkollë me të drejtë nxitet shumë;
- 'marrëdhënia', ndërmjet të barabartëve dhe me mësuesin.

Mënyra me të cilën fëmija i fut në lojë këto tri kërkesa, këto nevoja të vetat dhe ndërveprimin midis tyre – sepse natyrisht ndjenja e kompetencës është e lidhur me marrëdhënien që është e lidhur me afirmimin e vetvetes – është gjithmonë krejtësisht personale dhe ka të bëjë me temperamentin, me historinë personale, me besimin e tij bazë, me stilin e afeksionit që ka zhvilluar. Mënyra me të cilën ky besim bazë, kjo siguri që i bën të mundur fëmijës që të përballojë realitetin, strukturohet në vitet e para të jetës, për të mos thënë në muajt e parë, është vendimtare për të përcaktuar mënyrën me të cilën ai do të përballojë realitetin. Bëhet pjesë përbërëse e mënyrës me të cilën personi e përballon realitetin.

Edhe pse prindi nuk është garantues i suksesit shkollor, nuk mund ta shmangë bashkëndarjen e gjendjes shkollore të fëmijës së vet; në të njëjtën mënyrë në qoftë se detyra e mësuesit është të japë mësim, ai nuk mund ta shmangë marrëdhënien, edhe të ndjenjave, që fëmija është i prirur të ndërtojë me të rriturin, si edhe, për pasojë, angazhimin për të ndërtuar kushtet me qëllim që kjo marrëdhënie të jetë e mirë.

Dy janë kontekstet në të cilat fëmijës i takon të jetojë: familja dhe shkolla që duhet të shprehin për këtë një respekt të ndërsjelltë. Së bashku të rriturit e pranishëm që kanë një rëndësi domethënëse, përkatësisht prindërit dhe mësuesit, kanë detyrën që t'i bëjnë fëmijët / nxënësit të vetëdijshëm që detyra e tyre e rritjes nuk përbushet me një aspekt të vetëm të jetës, qoftë ky edhe nxënia ose suksesi shkollor. Për këtë marrëdhënie ndërmjet familjes dhe shkollës është e mundur, në përfundim, vetëm në qoftë se është krijuar mbi bazën e dimensionit edukues, dhe për këtë është thelbësore që shkolla, çdo shkollë, të veprojë brenda një 'projekti edukues', i cili të jetë garantues i kësaj marrëdhënieje.

Por të parashtrosh problemin e një projekti edukues nuk do të thotë t'i drejtohesh operativitetit në mënyrë të drejtpërdrejtë, por më

tepër të vështrosh drejt një vetëdijeje; nuk është një aftësi teknike që përcakton projektin edukues, por vetëdija që edukatori ka për vetveten si njeri, dhe domethënë si edukator, një vështrim që të jetë në gjendje të shikojë horizontet dhe vlerat sipas të cilëve synohet të përcaktohet dhe duke u nisur nga të cilët merr rregull përvoja ime njerëzore dhe sipas së cilës unë jam, për pasojë, i gatshëm për të shoqëruar fëmijën që më besohet mua për ta edukuar. Kuptohet kështu se si projekti edukues është në radhë të parë një rast për të verifikuar pozicionin njerëzor të edukatorit dhe vetëm së dyti një ndihmë për të përcaktuar karakteristikat dhe qëllimet që shkolla, si institucion formues, synon të vendosë në themelin e veprimtarisë së vet dhe për këtë arsye, edhe pse përgjegjësia e hartimit të projektit edukues nuk mund të jetë tjetër veçse i 'menaxhimit' shkollor, nuk mund të mungojë miratimi i hapur në të njëjtin projekt nga ana e prindërve dhe, duke u nisur nga ky miratim, mundësia për prindërit për të dhënë kontributin e tyre në mënyrë që orientimet që karakterizojnë projektin të përkthehen në orientime efektive në jetën shkollore konkrete, deri në aspektet e saj specifike më didaktikë.

Detyra e shkollës, ose e çfarëdolloj institucioni tjetër formues, nuk është në të vërtetë ajo e 'çkushtëzimi' i fëmijës, por ta ndihmojë atë që të shfaqë dhe të njohë në përvojën e vet faktorët që e përbëjnë dhe e mbështesin. Kjo do të thotë që të mos gjykohe përvoja familjare, por që ajo të bëhet e vërtetë, domethënë që të shfaqet pozitiviteti që sidoqoftë është i pranishëm në çdo përvojë njerëzore dhe, domethënë, në çdo përvojë familjare. Por të njëjtën gjë mund të themi për përvojën shkollore dhe për detyrën që merr familja kundrejt saj. Pikërisht për vështirësitë që hasen sot në përballjen e problemit të shkollës si kuadër edukues, njohja e familjes si një vlerë konkrete është pikënisja e nevojshme në angazhimin për të kuptuar vetveten si edukatorë dhe, duke u nisur nga njohja e këtij fakti, të përcaktohen aspektet teknike dhe operative në kuptimin e fortë.

Ka një mënyrë takimi me prindërit në lidhje me vlerat edukative, ndonjëherë intelektualiste dhe abstrakte, që vetëm duke njohur aftësinë e familjeve "konkrete" për të qenë vlerë për atë që është, vihet realisht në pikëpyetje. Pak rreshta të shkëputura nga një tekst jo rastësisht i titulluar "Rreziku edukativ", mund të ndihmojnë për ta kuptuar këtë pikë. "Vërejtjet e bëra zbulojnë një udhë të pashmangshme për çdo individ. Takimi me dikë që është për fëmijën ose për të riun mbartësi i asaj që e kemi quajtur 'hipotezë shpjeguese të realitetit', nuk është diçka që mund të shmangët. Vendi i parë ku ndodh kjo është, në të vërtetë, familja: hipoteza fillestare është botëkuptimi që kanë prindërit ose ata persona të cilëve prindërit ua ngarkojnë përgjegjësinë për edukimin e fëmijës së tyre. Nuk mund të ekzistojë një kujdes për fëmijën dhe një shqetësim për formimin e tij, përveçse në vizionin, të paktën të turbullt e të ngatërruar – pothuajse instiktiv – të një ndjenje të botës. Edukimi konsiston në futjen e të riut në njohjen e reales, duke saktësuar dhe duke e zhvilluar këtë vizion origjinal. Ai ka kështu meritën e paçmueshme të udhëheqjes së adoleshentit drejt sigurisë së ekzistencës së një kuptimi të gjërave. Realiteti, le ta përsërisim, nuk është afirmuar kurrë me të vërtetë, në qoftë se nuk është afirmuar ekzistenca e kuptimit të saj. Në këtë zgjidhet ajo nevojë absolute e unitetit që përbën shpirtin e çdo sipërmarrjeje të vetëdijes njerëzore".

Nëse, pra, familjes i atribuohet dhe i njihet të qenët e saj si faktor

futjeje në realitetin e përjetuar normalisht nga një fëmijë, për shkollën prej këtej rrjedhin udhëzime të sakta metode. Angazhimi me lëndën e studimit është gjithmonë edhe angazhimi për të vënë në dukje kuptimin e saj: “hyrje në realitet dhe në kuptimin e tij”, domethënë tek ajo që në realitet, për shkak të natyrës së vet shumëformëshe, accosta dhe rregullon pjesët e ndryshme që e përbëjnë atë. Dhe kjo mund të ndodhë vetëm duke u dhënë vlerë fragmente të realitetit, për të cilat ne bëhemi të vetëdijshëm. Në momentin që fëmija shpalos zgjuarsinë, takon realitetin, edhe në mënyrën specifike të shkollës, të disiplinave shkollore, është e nevojshme që ne gjithmonë ta mbajmë mend këtë. Këtu shfaqet me të gjithë forcën e vet detyra e prindërve dhe e mësuesve për të ofruar një horizont më të madh brenda të cilit të futet ajo që po i ofrohet fëmijës / të riut, mbartës i i së njëjtës strukturë të njeriut të rritur dhe, në ndryshim me atë që tepër shpesh i ndodh të rriturit, asaj do t'i qëndrojë besnik: domethënë, do të kuptojë çdo gjë të asaj që i ndodhet përpara, duke i shkuar deri në fund kërkimit.

Mësimdhënia është “zanati” i mësuesit, nxënia është “zanati” i fëmijës, dhe mësimdhënia nuk mund të ekzistojë nëqoftë se nuk ka si qëllim nxënien, jo një proces i thjeshtë që kërkon gjithmonë vënien në lëvizje të subjektit, domethënë edhe aktivizimin e atij dimensionit themelor të njeriut që ne e quajmë liri. Shumë shprehje na ndihmojnë për ta kuptuar më mirë këtë aspekt themelor të nxënies, disa prej të cilave janë veçanërisht të rëndësishme: “Nxënia është një akt i riorganizimit të marrëdhënies unë – bota”, “është një gjest i ridomethënies së botës së vet”, “asnjë ide, zotësi, aftësi shkollore nuk mund të shprehë forcën e vet dhe prodhimtarinë e vet, në qoftë se ajo nuk merret në universin e domethënies së njeriut, pra, në qoftë se nuk integrohet nën dritën e vlerave vetjake”.

Për këtë arsye, për të mbështetur aktivitetin e lirisë së të riut, mësuesi duhet të dijë të jetë një dëshmitar që thotë jo “bëni si bëj unë”, por “gjërat janë kështu”. Edukatori është gjithmonë në të vërtetë një dëshmitar, të cilin i riu ka prirjen që ta marrë si shembull, dhe ky aspekt i marrëdhënies edukative duhet të përballohet nga ana e atij që edukon duke pasur vetëdijen se ai mund të përfaqësojë një tundim të madh, në të cilin duhet ta shmangë rënien. Fakti që është i konsideruar si shembull i jep, në të vërtetë, një pushtet, i dhënë ky nga vetë të edukuarit, të cilin duhet të mësojmë që ta menaxhojmë dhe mundësisht, me maturi të madhe, ta përdorim, me kusht që të ndihmojë për ta shpënë vëmendjen e të edukuarit mbi atë që është e rëndësishme për të.

Edukatori është i rëndësishëm për të riun, sepse ai përfaqëson një “urë”, e cila ia bën më të lehtë takimin me realitetin dhe, përmes këtij takimi, të njohë vetveten. Duke e vështruar realitetin ashtu si mësuesi e sheh atë, në fakt, i edukuari në atë mënyrë të pavetëdijshme, kap në të, aspekte të përcaktuara, të botës dhe të vetvetes, mbi të cilat pyet veten. Udhë e edukimit është: nga vetja ime te realiteti, nga realiteti te vetja ime. Për të gjetur veten time - dhe kjo vlen sa për të edukuarin, aq edhe për edukatorin - secili prej nesh ka nevojë për diçka ose për dikë që është jashtë meje, që të më ofrojë një perspektivë të përshtatshme dhe që të më lejojë në këtë mënyrë të njoh dhe t’u jap vlerë veprimeve të mia dhe mendimeve të mia. Për këtë, rregulla edukuese themelore është për edukatorin të ndihmojë të edukuarin që të njohë pozitivitetin e asaj që e quajmë

përvojë; që kjo të ndodhë është pasojë jo e një kompetence profesionale, por e mënyrës me të cilën edukatori e shikon përvojën e tij. Për këtë arsye është e mundur t’i jepet edukatorit detyra e dëshmisë si kusht i nevojshëm për efikasitetin e veprimtarisë formuese.

Kjo perspektivë duhet t’i japë një shpirt marrëveshjes ndërmjet edukatorëve dhe prindërve, aq e nevojshme, që nuk duhet të mohojnë natyrën specifike të detyrës së tyre përkatëse, por ta vendosë atë në perspektivën e një objekti të përbashkët, rritjen e fëmijës / nxënësit. Dhe kjo marrëveshje duhet të fillojë të paraqitet që në kopësht.

Ky nivel i parë i shkollës është i karakterizuar sigurisht është i karakterizuar nga nevoja edukuese formuese të sjelljeve, sesa të strukturave të nxënies së formalizuar. Nëse duam të përcaktojmë fizionominë e kopshtit – jo rastësisht për shumë dhjetëvjeçarë është quajtur “shkollë amtare” – nuk mund të lihet mënjanë nga fakti që fëmija që hyn në këtë shkollë i parashton vetes vetëm një qëllim: që të përjetojë një përvojë e cila të jetë në gjendje, nga njëra anë, për ta konfirmuar atë në identitetin e tij që është duke u shfaqur dhe, nga ana tjetër, për t’i ofruar një zhvillim përvojës së vet, që për fëmijën ende ndodh brenda një marrëdhënieje vetjake të drejtpërdrejtë dhe të qartë. Prandaj edhe kopshti nuk mund të ekzistojë pa një referim të jashtëm, i cili në njëfarë mënyre është “rregullatori” i zgjedhjeve të tij.

Ndër referimet e shumta që mund të njiheshin si të përshtatshme për të orientuar shkollën (e domethënë, edhe kopshtin), sigurisht tre imponohen:

- format e dijës, dhe domethënë, në mënyrë të veçantë shkenca;
- konteksti institucional në të cilin shkolla është e përfshirë shkolla, dhe domethënë, veçanërisht, mënyra me të cilën çdo nivel lidhet me institucionet e tjera, të asistencës dhe të formimit, që kanë të bëjnë me fëmijët;
- përvojën e përjetuar nga fëmija, dhe domethënë, kryesisht përvojën familjare dhe marrëdhëniet me prindërit.

Zgjedhja ndërmjet këtyre tre “familjeve” të referimeve të mundshme nuk duhet parë në vetvete si “përjashtuese” (referimi i zgjedhur përjashton të tjerat), por më shumë si “urdhëruese” ose si “hierarkizuese” (tri referimet janë qetë gjitha të pranishme, por sipas një renditjeje të caktuar). Bëhet fjalë, pra, për të identifikuar kriteret të cilat, në kopësht, bëjnë të mundur një “hierarkizim”.

Në qoftë se ne mendojmë se kopshti është në radhë të parë, “i” fëmijës dhe jo “për” fëmijën, referimi që ka lidhje me përvojën e fëmijës merr një rol të privilegjuar, ashtu sikurse nuk ka dyshim që fëmija paraqitet në kopësht me një përvojë të veten të marrëdhënies vetjake që ka zhvilluar në familje, është po aq e qartë që atje krijohet identiteti i tij, qoftë sepse vlerat dhe modelet atje janë marrë, qoftë sepse në mënyrë shumë më të thellë, fëmija e percepton vetveten se “i përket” familjes, ose më mirë, njerëzve të cilët konkretisht e përbëjnë familjen, në radhë të parë, nëna dhe babai.

Zgjedhje të ndryshme do të sillnin një formalizim dhe një ngurtësim të udhëve dhe të metodave të mësimdhënies, duke ndihmuar në këtë mënyrë në krijimin e një largësie ndërmjet fëmijës dhe objektivave të propozuar, duke e bërë më pak të lirë udhën

e shoqërizimit, dhe mbi të gjitha, duke mos e konfirmuar “objektivisht” subjektin në marrëdhëniet e tij me subjektet e tjera, një situatë kjo që te fëmija duhet të mbështetet duke u nisur nga një marrëdhënie ekzistuese, në të cilën i rrituri është garantues, udhërrëfyes dhe shok i fëmijës dhe që e gjen formën e tij të parë në marrëdhëniet me prindërit.

Kjo do të thotë se shkolla duhet t'i shtrojë vetes një pyetje mbi përvojën familjare të fëmijës, të marrë fëmijën në përfshirjen në një marrëdhënie shumë të karakterizuar që mund të gjykohet vetëm mbasi është pranuar. Të njihet diversitetin si identitet, të pranohet se kjo është përcaktuar nga familja cila është, do të thotë, pra, të njihet konkretisht se identiteti i fëmijës është i lidhur me një “përkatësi”, pa të cilin fëmija nuk do të ekzistonte, nga asnjë pikëpamje dhe jo vetëm nën profilin biologjik apo atë të sjelljes. Për këtë arsye, edhe nëse përvoja familjare do të ishte për disa apo për shumë në dukje negative, ajo megjithatë duhet të njihet si një burim i identitetit të fëmijës dhe, prandaj, jo vetëm si një e dhënë, por si një burim i një mundësie, ndoshta më domethënësja për të filluar dhe për të vazhduar një rrugëtim pozitiv së bashku me vetë fëmijën.

Të njihet fëmija si një mbartës i një specifike apo veçorie, të shihet, pra, si mbartës i një identiteti, është hapi i pashmangshëm për çdo të rritur që dëshiron të fillojë një raport efikas, në mënyrë të veçantë në kontekstin shkollor. Nga ky këndvështrim, kopshti është një vend i privilegjuar, sepse në të me më shumë lehtësi, mund të thohim me natyrshmëri, shoqërizimi dhe dimensionit i aftësive veprim në sintoni midis tyre; duke njohur rëndësinë qendrore të detyrës edukative pranohet ekzistenca e një marrëdhënieje të ngushtë ndërmjet dimensionit afektiv dhe dimensionit njohës, duke ndihmuar kështu që të fillojë dhe të konfirmohet vëmendja e fëmijës drejt njohjes së realitetit. Në këtë mënyrë, zgjerohet hapësira familjare, por pa ndryshuar karakteristikat themelore të marrëdhënieve që fëmija tashmë eksperimenton. Edhe për këtë arsye, nën profilin e njohjes apo të aftësive, përveçse nën profilin edukativ, kopshti nuk duhet të jetë një “univers” i ndarë nga ai familjar. Në qoftë se fëmija nuk do ta perceptonte një unitet të mundshëm ndërmjet shkollës dhe familjes, ai do të ndihej i detyruar që të zgjidhte ndërmjet dy përvojave të referimit dhe ky tension nuk do ta favorizonte rritjen e tij. Por megjithatë, nuk mjafton që të ekzistojë sintonia pozitive ndërmjet mjedisit shkollor dhe kontekstit familjar: është e nevojshme gjithashtu, edhe që ai të mund të njihet nga fëmija. Për këtë arsye, duhet të manifestohet, më përpara se në mënyrat e organizimit abstrakte të edukimit dhe të vlerave, nëpërmjet mënyrave konkrete që kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis njerëzve që veprojnë në shkollë dhe në familje, në radhë të parë mësuesit dhe prindërit. Edhe një përshëndetje e përzemërt, qoftë edhe e rastësishme, mund të përfaqësojë për fëmijën një fakt me një rëndësi të madhe, nëpërmjet të cilit të perceptojë një marrëdhënie pozitive midis mësuesit dhe prindit. Problemi i kontributit të familjes në jetën e shkollës kalon, pra, para së gjithash, nëpërmjet veprimeve konkrete, sidomos atyre që janë pjesë e jetës së përditshme dhe që, pikërisht për këtë arsye, njihen menjëherë nga fëmijët.

Por sigurisht ka rëndësi edhe marrëveshja ndërmjet shkollës dhe

prindërve në lidhje me vlerat që duhet të frymëzojnë edukimin. Kjo duhet të kryhet mbi të gjitha që të stimulojë ballafaqimin ndërmjet të rriturve mbi këto tema dhe t'i bëjë, në këtë mënyrë, mësuesit dhe prindërit, më të vetëdijshëm për vlerat dhe parimet mbi të cilat e mbështesin jetën e tyre, dhe që të cilat ua propozojnë fëmijëve / nxënësve.

Është kjo një pjesë e rrugëtimit shkollor qendror në jetën e çdo të riu, sepse e shoqëron atë për një periudhë shumë të gjatë (nga 8 deri në 10 vjet të jetës), në një moment vendimtar për shkak se fillohet nga një fëmijë dhe përfundohet nga një adoleshent, nganjëherë nga një i ri që tashmë është i hapur ndaj përgjegjësive të botës së të rriturve. Edhe në këtë pjesë familja vazhdon të jetë një realitet që shkolla duhet ta marrë, sepse vetëm në këtë mënyrë është në gjendje të pranojë, të kuptojnë dhe të mbështesë rrugëtimin e rritjes së nxënësit. Thelbi i reflektimit që janë bërë në lidhje me kopshtin nuk është kapërcyer, edhe pse fëmija, sidomos në pjesën e dytë të këtij rrugëtimit, paraqitet gjithmonë e më shumë si një subjekt në gjendje që të përfaqësojë në mënyrë të drejtpërdrejtë faktorët që e karakterizojnë përvojën e tyre familjare dhe që të marrë përsipër konfliktet e mundshme të lindura gjatë ballafaqimit ndërmjet dy botëve, të familjes dhe të shkollës.

Kjo nuk do të thotë që raporti i “porositjes” ndërmjet prindërve dhe shkollës të zhduket, por që në të rinjtë të marrin një rol të vetin specifik dhe në rritje. Ashtu sikurse bëhet më e rëndë prania e subjekteve të tjera të interesuara për ekzistencën dhe funksionimin e institucionit shkollor, që i kërkojnë të orientohet drejt objektivave të përcaktuara, të cilat duhet të arrihen mundësisht në pjesën më të madhe të rasteve. Gjithashtu, shkolla zotëron një përgjegjësi të vetën dhe origjinale, e cila përket mbi të gjitha në përgatitjen e formave të shërbimit mbi bazën e objektivave të nxënies dhe të zgjedhjeve metodologjike të bëra. Por e gjithë kjo nuk mohan faktin se të pranosh fëmijën do të thotë të pranosh (potencialisht) gjendjen e tij familjare pozitive.

Edhe kur është fjala për shkollën fillore (edhe më shumë për shkollën e mesme) tre parimet e mundshme rregulluese që kemi kujtuar, duke e futur temën në kopësht, mbeten, edhe pse marrëdhëniet janë në zhvillim. Perspektiva në të cilën njihen ndryshon gradualisht, ndërkohë që aspektet që kanë të bëjnë me aftësitë dhe, më pas edhe me ato me natyrë njohëse, marrin një rëndësi më të madhe. Aspektet edukative mbeten gjithmonë një pikë e vëmendjes nga e cila nuk mund të hiqet dorë, por pesha që kanë mbi to aspektet e marrëdhënieve ulët, ndërkohë që rritet pesha e atyre që kanë të bëjnë me objektin dhe me objektivat e punës që së bashku duhet të përmbushim.

Këto konsiderata të fundit rezultojnë të jenë vendimtare për të kuptuar kushtet (dhe problemet) në të cilat vendoset marrëdhënia ndërmjet të gjithë atyre konteksteve joshkollore që mund të jenë pjesë e përvojës së të rinjve, ndër të cilat një rëndësi të veçantë kanë “qendrat ditore” dhe familja.

Karakteristikë e këtyre konteksteve është se ato në përgjithësi veprojnë duke u nisur nga një nevojë për të mbështetur të riun, kushtet e të cilit nuk janë të specifikuar “a priori”, sikurse ndodh në të kundërt në shkollë. Vëmendja për të ndërtuar një dimension të vetin

profesional, domethënë për të punuar mbi detyrën e vet dhe mbi rolin edukativ, për ta kuptuar më mirë atë, ka pra, në qendër të saj edhe një vëmendje dhe një aftësi për të lexuar situatën, përveç aftësisë për të “projektuar” veprime dhe situata edukative të përshtatshme me kushtet specifike në të cilat edukatorit i kërkohet që të punojë. Kjo duhet të shoqërohet edhe nga durimi për të mbajtur disa pyetje si bosht referimi; ndërmjet këtyre, themelore janë dy pyetje: Ku po shkoj? Si po e përfshij tjetrin në këtë rrugëtim?

Nga kjo perspektivë emfatizohet një tipar i veçantë i profesionalizmit të edukatorit: të tregojë një drejtim, një pikëmbërritje dhe ta marrë përdore të edukuarin. Prandaj edhe është absolutisht e nevojshme që edukatori të jetë i vetëdijshëm se shoqërimi po ndodh në këtë “mënyrë”, në këtë “vend”, në këtë “moment”, të gjitha këto kushte në mënyrë që secili të mundet të njohë drejtimin në të cilin ecet. Për vetë natyrën e tij, në fakt, edukimi, edhe pse duhet të mbetet i rrënjësor fort në realitet, është e orientuar drejt asaj që “ende nuk është”, por që do të mundet të ndodhte; duhet, pra, të jetë në gjendje për të shoqëruar të edukuarin drejt situatave të reja, të cilat për shumë aspekte janë të panjohura, me synimin qoftë të plotësimit të identitetit të të edukuarit, qoftë të një mundësie shprehjeje të tij dhe, për këtë arsye, të ndikimit mbi vetë realitetin.

Në qoftë se është e vërtetë se edukimi kryhet sot duke pasur si synim të nesërmen, për të kuptuar se në cilin drejtim është duke shkuar ai, nuk mund të mos ketë aftësinë për të bërë të ditur se çfarë ndodhi dhe: çfarëdo drejtimi, në të vërtetë, mund vetëm të njihet vetëm duke identifikuar dy pika, dhe sa më shumë këto pika janë larg nga njëra – tjetra, aq më shumë ngushtohet fusha e probabilitetit. E kaluara është vendi në të cilin duhet të kërkohet ky referim i dytë, i cili, së bashku me vetëdijen e të sotmes, bën të mundur që të përballohet e ardhmja me vetëdije. Dhe për ta bërë të mundur këtë, për ta bërë të pranishëm në përvojën e përjetuar nga i edukuari, është detyrë e edukatorit.

Mund të ndodhë që drejtimin ta caktoj unë, dhe mbetet imi; ose që të nisem nga përvoja e të rinjve. Edhe të rinjtë e kanë një histori, ndoshta i përkasin së njëjtës, si edhe unë, por e kaluara e tyre është e kaluara ime: por elementët e sigurt të së kaluarës së tyre nuk janë menjëherë në harmoni me ato të së kaluarës sime. Është e qartë për secilin që e kaluara si traditë është shtrati i përbashkët, brenda të cilit mund të njihen dhe të dallohen një shumëllojshmëri situatash të ndryshme, ndonjëherë edhe të kundërta. Është po aq e pamohueshme që e gjithë kjo të mbahet parasys, duke qenë se është ekzistuese dhe duhet të vlerësohet, sepse është mirë që të ekzistojë një shumëllojshmëri dhe që ajo të mbetet e gjallë. Në qoftë se është e vërtetë, në fakt, se qëllimi i edukimit për secilin është që të bëhet vetvetja, atëherë vetvetja nënkupton për natyrën e vet një diversitet.

Kjo prani e së kaluarës, që duhet të shfaqet në rrugëtimin edukativ, quhet pikërisht “traditë”, ajo që nga e kaluara është ende e pajisur me kuptim në të tashmen dhe, për këtë arsye, është e përbashkët për një grup të tërë shoqëror. Edukatori duhet të ketë të qartë këtë gjë: se e kaluara si traditë shfaqet gjithmonë edhe nga pozicioni i tij që duhet ta dëshmojë në mënyrë konkrete, duhet të mbështetet mbi të dhënat e identifikueshme nga i edukuari, duhet të bëhet objekt verifikimi. Së dyti, nuk duhet të harrojmë që e

kaluara e të edukuarit është para së gjithash përvoja e tij familjare dhe që për këtë arsye nuk duhet të mospërfillet kurrë.

Traditë nuk është diçka e pandryshueshme, edhe pse në këtë moment na bashkon, duke qenë se në të jemi (kemi qenë) të gjithë pjesëmarrës. Vlera e saj edukative qëndron, pra, para së gjithash, në faktin se, nëpërmjet saj, i edukuari mund të njohë rrënjët e veta (të cilat jo domosdoshmërisht janë pozitive) si pikë e parë e krahasimit për përvojën e vet të porsalindur. Tradita në këtë mënyrë bashkon, pa asgjësuar karakterin e veçantë që secili prej nesh mbart. Dhe kjo është një e mirë, sepse përndryshe edukimi do të kishte prirjen për t'i bërë të gjithë të njëjtë: madje, të gjithë të njëjtë me mua! Dhe ky është një tundim i pranishëm, edhe në mënyrë të pavetëdijshme, tek edukatori, i cili është mbartës i një përvoje më të fortë mbasi është më e vërtetuar.

Një marrëdhënie në vazhdimësi e sipër, e hapur, me familjen përfaqëson, pra, një parakusht themelor në mënyrë që veprimtaria e një qendre edukative të përfaqësojë një mbështetje efektive për rritjen e të edukuarit. Dhe kjo detyrë është një pjesë përbërëse e profesionalizmit të edukatorit joshkollor.

FAMILJA NË POPULLIN SHQIPTAR.

1) Koncepti i familjes.

Ajo që na bën që të jemi së bashku sot, është edukimi dhe për këtë arsye, njohja e faktorëve që na ndihmojnë në punën tonë ka një rëndësi parësore.

“Në të mirë apo në të keq, secili prej nesh është produkti i familjes së vet të prejardhjes, qoftë në formimin fizik, qoftë në atë psikologjik, shoqëror dhe moral.”

Besimi që ka secili në vetvete, mënyra që secili përdor për të hyrë në kontakt me të tjerët, për të fituar apo për të humbur, për të dashur apo për të urreyer, për të mbizotëruar apo për t'u mbizotëruar nga të tjerët, varet jo pak nga marrëdhëniet që kemi mësuar falë kontakteve me prindërit tanë.

Gjërat që ne i konsiderojmë të rëndësishme në jetë (vlerat), objektivat që ndjekim, mënyra jonë e të vepruarit për të zënë një vend në shoqëri, janë në funksion të vlerave të fituara në mjedisin familjar.

Ja se përse është e rëndësishme njohja dhe vlerësimi i kësaj të dhëne natyrore. Jo vetëm e rëndësishme, por edukatorit i duhet ta njohë, ta pranojë, dhe ta vlerësojë atë pa asnjë gjykim.

ÇFARË ËSHTË FAMILJA?

Ekzistojnë përkufizime të ndryshme, disa prej të cilave ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme njëra nga tjetra.

Nën aspektin sociologjik familja është një grup shoqëror, i përbërë nga dy apo më shumë njerëz me lidhje gjaku, martesë apo birësimi, të cilët jetojnë së bashku për periudha të gjata, kanë një ekonomi të përbashkët dhe përkujdesen për rritjen e mire të fëmijëve të tyre.

Ndërsa në *psikologjinë e zbvillimit*, ajo është përkufizuar si një qelizë, në të cilën ka të paktën një marrëdhënie prind – fëmijë. Njësia themelore dhe natyrore e shoqërisë, njëra prej njësive më të përsosura, më të sigurta, më mbrojtëse, më të gjithëkuptueshme kundrejt anëtarëve të vet.

Ashtu sikurse të gjitha strukturat e tjera, edhe familja nuk mund ta shmangte evolucionin e saj të natyrshëm.

Pavarësisht nga karakteristikat, nga vonesat historike, familja shqiptare ka përkufizuar të gjitha fazat dhe etapat e natyrshme të zhvillimit. Ajo, me sa duket, është njëra prej institucioneve shoqërore, evolucionin e saj në cilës nuk paraqet asnjë veçori ose devijim nga “kurba historike”.

Natyrisht, sikurse do ta trajtojmë në vazhdim këtë çështje, për shkak të pabarazisë së nivelit të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe kulturor, kemi pasur një “zhvendosje”, e cila është diktuar nga koha dhe nga rrethanat historike, evolucionin e familjes shqiptare nuk ka ndodhur gjithmonë në të njëjtën “kohë kontinentale.”

2) Familja dhe evolucionin e saj :

a) Familja shqiptare përpara çlirimit.

Historia e familjes shqiptare ka kurbën e vet të zhvillimit, e cila ka filluar me llojin e familjes së madhe patriarkale, e cila përbën formën më të lashtë të familjes, që ka përkufizuar një periudhë të gjatë historike të jetës së vet dhe të mbijetesës së vet, duke qenë lloji më tradicional i “familjes kolektive”.

Në fazën e parë, e cila përfshin periudhën deri në çlirim (në fundin e Luftës së Dytë Botërore), ishte mbizotëruese **familja e hapur**, e cila ishte e përbërë nga një numër i madh personash dhe ishte shumë e lidhur me fisin.

Ekonomia tradicionale diktonte marrëdhënie të ngushta ndërmjet personave, familja kishte prirjen të ishte e lidhur me fisin, tregues, ky, i një mendësie, sipas së cilës të gjithë janë të lidhur, pranë njëri – tjetrit, punojnë së bashku dhe bashkëndajnë të njëjtat probleme.

Lidhjet e fafisnisë ushtronin një ndikim vendimtar në zgjidhjen e shumë problemeve dhe në mbrojtjen e asaj që konsiderohej si gjëja më e shenjtë, të familjes.

Me qëllim që të fuqizohej (fisi), nëpërmjet përforsimit të marrëdhënieve me fiset e tjera, lidhjet martesore nënkuptoheshin dhe realizoheshin si aleanca ndërmjet fiseve të të dy bashkëshortëve të ardhshëm. Ndërtimi i saj (domethënë, i familjes së re) nuk bazohej mbi ndjenjën e dashurisë, por kryesisht mbi interesat ekonomike dhe shoqërore të prindërve dhe të të afërmeve, dhe jo rastësisht fejesat lidheshin nga burrat që atëherë kur krijesa ende ndodhej në barkun e nënës.

Teksa rrinin në dhomën e burrave dhe bënë mubabet, hyn gruaja e Zef Markut, entra hyn për t'u sjellë atyre kafetë, ishte shtatzënë.

Prele Kola, sapo e vuri re, duke e njohur reputacionin e mirë të familjes së Zef Markut dhe, duke e ditur se e kishte pre-

ardhjen nga një fis i njohur në ato anë për trimërinë e tij, i drejtohet bashkëshortit, Zef Markut.

Zef Marku, a e bëjmë një krusbqi sot? Në qoftë se gruaja jote do të lindë vajzë, do ta fejojme me djalin tim, që tani është një vjeç.

Zef Marku, i zënë pakëz në vështirësi, por duke pasur parasysh marrëdhëniet e mira me Prele Kolën dhe me fisin e tij, i përgjigjet:

Qoftë e bërë krusbqi! Në qoftë se fati do të dojë që të jetë vajzë

Vjen çasti i lindjes. Gruaja e Zef Marku lind një vajzë, e cila ishte tashmë e fejuar.

Mbas jo më shumë se dy vjetësh, djali i Prele Kolës sëmuret nga fruthi dhe më pas vdes.

Por si i dubej bërë? E kishte dëbën tashmë fjalën për vajzën ...

Koba kalonte, por askush nuk kishte guxuar të fliste më për këtë, mbasi vdekja e të birit kishte qenë shumë e dhimbshme.

Atëherë, për të ruajtur miqësinë dhe për të mbajtur premtimin, burrat vendosën kështu: vajza e Zef Markut do të martohet me djalin e vëllait të Prele Kolës, edhe pse midis atyre të dyve kishte një diferencë të madhe moshe.

Dhe kështu u bë, në të vërtetë.

Atëherë, le të ndalemi dhe të diskutojmë: Të gjithë jemi të vetëdijshëm që këto gjëra nuk ishin normale, por të nisemi nga ajo që ishte pozitive dhe nga vlerat e saj.

Shpirti njerëzor dhe altruista, që e ka karakterizuar gjithmonë shqiptarin, dëshira për ta ndihmuar tjetrin në rast fatkeqësie, deri edhe në mohimin e interesave vetjake, mbajtja e premtimit të bërë, pavarësisht nga rrethanat, janë treguesi më i mirë i vlerave të familjes **tradicionale shqiptare**.

Mbajtja e premtimit dhe bindja kundrejt njerëzve më të mëdhenj në moshë, në mënyrë të veçantë të prindërve, ishte një ligj i pashkruar, të cilin fëmijët e mësonin që në lindje.

Numri i anëtarëve të familjes ishte mjaft i lartë, deri në 32, nuk ishin të pakta rastet në të cilat në të njëjtën familje bashkëjetonin disa breza dhe disa çifte të martuara.

Në shoqërinë tradicionale shqiptare, veçanërisht në zonat rurale, burri, me statusin e të parit të shtëpisë, gëzonte një autoritet të padiskutueshëm. Ai kishte një pushtet pothuajse të pakufizuar, jo vetëm mbi pronën, por edhe mbi veprimtarinë e anëtarëve të familjes. Anëtarët e familjes nuk kishin të drejtë të kryenin asnjë lloj veprimtarie, dhe as të merrnin ndonjë nismë, edhe pse të rëndësishme, pa dijeninë e tij. I pari i familjes quhej “i zoti i shtëpisë”, ndërsa anëtarët e tjerë të familjes quheshin “rob shtëpie”, gjë që ishte tregues i nënshtrimit të tyre të plotë ndaj tij.

Potenciali i familjes vlerësohej nga numri i anëtarëve dhe, për më tepër, nga numri i meshkujve, dhe kështu, aborti ishte i papranueshëm. Ndërsa divorci konsiderohej jo vetëm i papranueshëm, gjë e cila gjente mbështetje nga kleri i të tri feve, të cilët e konsideronin

divorcin si një shprehje dhe shkak i veseve të ndryshme të shoqërisë, duke e argumentuar deri në atë pikë ku thoshin se: “Njeriu, dhe në mënyrë të veçantë gruaja, nuk duhet ta kërkojnë divorcin, edhe nëse është në kundërshtim me interesat e tyre vetjake.” Dhe argumentimi shkonte edhe më tej, duke përfshirë gjithashtu edhe aspektin shoqëror, “zëri i fëmijëve dhe zëri i kombit thërret ashpër kundër divorcit, sepse edukimi i fëmijëve është i gjymtuar, në qoftë se mungon: “ose dashuria e ëmbël dhe e butë e nënës, ose rregullimi dhe shtrëngimi i mençur dhe i pjekur i babait.”

E gjithashtu, edhe “kanuni” (kodi i së drejtës zakonore i asaj kohe) e dënonte divorcin, sepse sipas tij “vetëm në rast vjedhjeje dhe banditizmi, burri e le gruan e tij”.

Pavarësisht gjithë këtyre arsyetimeve, nxitjeve dhe përpjekjeve, edhe në vendin tonë në fund të Luftës së Dytë Botërore fenomeni i divorcit ka shënuar rritje.

b) Familja dhe evolucioni i saj gjatë regjimit komunist.

Më vonë, ky lloj i familjes shqiptare, me zhvillimin e qytetërimit u zëvendësua nga “familja e gjerë”, e përbërë zakonisht nga “tre breza” që jetojnë së bashku, gjyshërit, prindërit dhe fëmijët e tyre. Ky model i familjes shoqërore ka qenë tipik gjatë gjithë periudhës historike të familjes gjatë komunizmit. Kjo strukturë me “tre breza” ka përbërë familjen tipike shqiptare, mbizotëruese për një periudhë prej 50 vjetësh, si model dhe strukturë, duke u konsideruar nga shoqëria e asaj kohe si një “model moral” i familjes së rregullt, që funksiononte, e cila ishte e ndihmuar dhe e përkrahur, si një paradigme e një modeli të organizimit shoqëror, modern, njerëzor, të detyrueshëm, të domosdoshëm.

Kjo formë e familjes (si më sipër), si rezultat i një sërë zhvillimesh komplekse, është ruajtur deri më vonë, në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore, madje ajo e ka ruajtur pak ndikimin e vet për disa vjet, mbas vendosjes së regjimit komunist, në mënyrë të veçantë në zonat e thella malore.

Kjo mënyrë jetese ka pasur ndikimin e saj pozitive dhe negativ, që për vite të tëra do të lenë gjurmë Të cilat do të ndikojnë dukshëm në edukimin e brezave, në përcjelljen e traditave, në marrëdhëniet e mëvonshme ndërmjet fëmijëve dhe prindërve.

Si pasojë e përzierjes së popullatës, përforcimit të kontrollit nga ana e organeve shtetërore dhe e organizatave shoqërore mbi të gjithë veprimtarinë dhe mënyrën e jetesës së njerëzve: lidhjet e farefisnisë dhe numri i familjeve shumë të mëdha ka rënë në mënyrë të konsiderueshme ...

Kjo ndodhi pavarësisht se ishin marrë masat e para në sektorë të ndryshëm.

Në vitet 1950 - familja ishte e përbërë nga një grup më i vogël njerëzish, por sidoqoftë ende ruante një numër të madh anëtarësh brenda saj, 11-14 anëtarë, dhe jo rrallë kishte familje të cilat numëronin më shumë se 15 anëtarë dhe lidhjeve të forta gjaku ...

Kisha dëgjuar të flitej për dy bashkëmoshatarët e mi që kishin shkuar në shkollë (shkolla shtatëvjeçare ishte larg, sepse në fshat ende nuk ishte hapur).

Mendimi i ngulitur për të shkuar atje më dha guximin që të flisja për këtë gjë me babanë tim.

Kur ia thashë këtë gjë, në fillim mbeti i babilitur, ndërsa më pas u zemërua.

- Ti mendon se ajo shkollë do të të japë për të ngrënë? Të mjaftojnë tashmë ato katër klasët – më tha ai: - e pastaj, kopenë e bagëtime kush do ta ruajë?

Por unë nuk hoqa dorë nga dëshira ime, dhe kështu një ditë ai më tha: - Merre me vete Palin (vëllanë tim më të vogël): dubet të mësojë të ruajë delet -.

Dhe kështu, mbas rreth një jave, më tha: - Sot do të qëndrosh në shtëpi, sepse në mesditë, kur të kthehem unë, do të nisemi.

- Po çfarë duhej të përgatisja? Në një bobçe, futa rrobata që ishin aq pak, por nga gëzimi i madh nuk doja t'ia dija fare për këtë. I përpiktë, babai im mbërriti ... dhe u nisëm. Udhë ishte e gjatë, pak a shumë një tetë orë, më këmbë. Ndonjë herë, gjatë udhës, më thoshte: - Po pikërisht tani, që mund të bëheshe krabu ynë, po na le -. Unë e dëgjoja dhe nuk flisja, mbasi isha i bindur se ajo që po bënte babai im ishte një sakrificë.

Ishte bërë natë, kur babai im më tha: - Sonte natën do të rrimë për të fjetur te një kumbar; nesër në mëngjes do të ngrihem berët dhe do të të le të shkolla ... sepse unë dubet të kthehem ...-. Kur m'i tha këto fjala, ishim shumë afër për të mbërritur atje, sepse babai im doli nga rruga kryesore dhe u drejtua për te një shtëpi. Mbasi thirri te dera: - O i zoti i shtëpisë – hymë brenda.

Gjatë bisedë, babai im i shpjegoi kumbarit se për ku po shkonim.

- Më vjen keq për ty, - i tha kumbari – që nuk ke dele në shtëpi. – Sipas tij, në fakt, vetëm të varfërit, që nuk kanë as tokë, as dele, i shpien fëmijët në shkollë. – Unë, shkollën, këtu afër shtëpisë e kam dhe nuk e kam lejuar asnjë prej fëmijëve të mi që të shkojnë atje – vazhdoi ai ...

E shtruan tryezën, por unë nuk kishta uri ... më vunë të flija më shpejt, por nuk kishta gjumë; kisha frikë se mos babai im do të ishte ndikuar shumë nga ajo që i kishte thënë kumbari, sepse ai ishte i njohur si një burrë “i zgjuar” dhe i zoti, dhe fjala e tij kishte shumë peshë. ...

Kishin filluar të këndonin gjelat e parë, kur babai im u ngrit.

- Përse kaq shpejt, shkolla nuk hapet kaq shpejt? – i thashë.

- Visbu dhe dalim, pastaj do të ta shpjegoj, – më tha ai. Por nuk kishte nevojë që ai të ma shpjegonte, sepse unë tashmë kisha kuptuar gjithçka.

U kthyem mbraps në fshat, dhe unë vazhdova të ruaja kopenë e deleve ... derisa një ditë të bukur bënë kolektivizimin dhe delet m'i morën, por tashmë unë nuk e kisha më moshën për të shkuar në shkollë, thjesht duhej të punoja në kooperativë ...

Në këtë periudhë, masat e marra nga qeveria në sektorë të ndryshëm (në bujqësi, ekonomi, arsim, shëndetësi) shënuan shfaqjen e filizave të një **evolucionit** dhe të një ndryshimi të detyruar të këtij modeli dhe kështu filloi të shfaqej nën zë dhe gradualisht modeli i ri i “**familjes me një bërthamë**”, e cila në përfundim ishte shfaqur si “lloji mbizotërues”, që në vitet '30 të shekullit XX. Në këtë ndryshim kanë ndikuar shumë faktorë zhvillimi dhe emancipimi shoqëror dhe kulturor.

Konfiskimi i pasurisë solli efektet e veta të menjëhershme mbi përbërjen dhe mënyrën e jetesës së familjes shqiptare. Tashmë nuk kishte më as prona, as pronarë, kjo shënoi në njëfarë mënyre “çlirimin” e fëmijëve nga punët dhe mundësia e arsimit masiv u rrit ndjeshëm.

Kundrejt atyre që pengonin arsimin e fëmijëve merreshin masa ndëshkimore, deri në burgim.

Shumë prej anëtarëve të familjeve, ende të shumta në numër, sepse ishin të zgjeruara, largohen në mënyra dhe në drejtime të ndryshme, për arsye pune, studimi, etj., duke shkaktuar në këtë mënyrë një lloj qarkullimi të popullsisë, do të mund të thoshim një migracion të brendshëm. Kështu pra, ndarja e punëve dhe marrëdhëniet nuk ishin më të njëjtat, fillon të shfaqet individualizmi tek anëtarët e familjes, shfaqet nevoja për t'u punësuar dhe për të përparuar nën aspektin ekonomik, shoqëror dhe kulturor.

- Mungesa e kushteve dhe e standardeve të një jete normale për një familje të përbërë nga disa breza, për shkak të mungesës së hapësirave normale të banesës, si edhe mungesa drastike e artikujve ushqimorë, që i detyronte ata të ndaheshin në mënyrë që të siguronin një racion më shumë artikujsh ushqimorë.

- Fuqia e epokës ndikonte dhe jo rrallë ndërhynte në mënyrë të drejtpërdrejtë në çështjet e brendshme të çdo familjeje.

- Mbështetja dhe “emancipimi i gruas”, në përgjithësi, e ka fuqizuar pak më shumë pozicionin e saj në shoqëri dhe në familje dhe janë këto vitet që shënojnë pothuajse një “përmbyse” të patriarkatit (në vendin tonë), duke i dhënë barazinë rolit të gruas dhe të burrit në shoqëri, por nuk qe një përmbyse e plotë brenda familjes, mbasi ishte e vështirë të arrihej të ndryshohej mendësia, individit nuk e gëzonte të drejtën e fjalës dhe çështjet vetjake brenda familjes ishin objekt diskutimesh i grupeve të ndryshme dhe i organizatave shoqërore.

Ajo që i ofrohej me siguri ishte lumturia që ndiente teksa shikonte fëmijët të rriteshin dhe nënshtrimin në heshtje ndaj bashkëshortit, sesa të bëhej objekt diskutimesh dhe kritikash të pafundme. Meqenëse gratë punonin jashtë ekonomisë shtëpiake, dhe ndiheshin më të sigurta ekonomikisht dhe më të lira për të kërkuar divorcin, mbeteshin prapëseprapë nën presion, pësonin përcmimin e opinionit publik dhe, jo rrallë, merreshin masa ndëshkimore, në mënyrë të veçantë kundrejt atij që konsiderohej fajtor. Në çdo rast, të dhënat statistikore tregojnë një lloj rritjeje të numrit të divorceve dhe të aborteve. Familja “me një bërthamë” (bashkëshorti, bashkëshortja dhe fëmijët) në këtë periudhë (domethënë, të komunizmit), duke mos qenë moralisht e mallkuar

nga politika zyrtare si “blasfemuese”, nuk u bë një fenomen masiv, lidhja dhe përkujdesja e ndërsjelltë e brezave në familjen e ndarë kanë qenë të pandërprera. Me kalimin e viteve, familja tradicionale shqiptare ka trashëguar këto karakteristika: **jetë e përbashkët dhe e qëndrueshme**, duke i dhënë përparësinë kujdesit për fëmijët, mirërritjes së tyre dhe pranisë së afërt të prindërve. Në atë kohë ishte kjo ajo që prindërit u përcillnin fëmijëve të tyre.

b) Familja që nga vitet '90 dhe deri në ditët e sotme.

Ndryshimet demokratike në realitetin specifik shqiptar dhe tranzicioni i vështirë, hapja dhe përshtatja e mendësive dhe e stilit të jetesës perëndimore, emigracioni, zhvendosja e një pjese të madhe të popullsisë nga zonat rurale drejt qendrave urbane, kanë çuar në formimin e një modeli të ri të familjes shqiptare, në ndryshime të mëdha në pamjen dhe në karakteristikat e saj tradicionale. Edhe marrëdhëniet në familje kanë ndryshuar dhe këto ndryshime kanë çuar në një sërë fenomenesh pozitive dhe negative.

Në procesin e zhvillimeve demokratike postkomuniste, prirja më e dukshme në vendin tonë është ajo e familjes **me bërthamë të mbyllur**, të përbërë nga një numër i vogël, deri në pesë anëtarë, por që u shoqërua nga një lloj rigjallërimi psikologjik i fisit dhe i lidhjeve të farefisnisë, gjë që është shfaqur kryesisht në zonat e thella malore, me një popullsi më pak të përzier, si rezultat i dobësisë të organeve shtetërore. Nuk kanë qenë të pakta rastet në të cilat procesi është shoqëruar nga një rigjallërim i mendësisë patriarkale konservatore, i cili peshon shumë në jetën e të rinjve dhe grave. Në kalimin nga totalitarizmi në demokraci, familja është përballur me shumë vështirësi qoftë në qytetet, qoftë në zonat rurale.

Në qytete: për pjesën më të madhe të shoqërisë (mbasi një pjesë e vogël e saj u pasurua), papunësi dhe varfëri të skajshme dhe, për këtë arsye, përpjekje për një jetë më të mirë. Anëtarët e familjes, me shpresën e një jete më të mirë për veten e tyre dhe anëtarët e tjerë, do të emigronin drejt vendeve më të zhvilluara.

Në zonat rurale: Mungesa e infrastrukturës dhe të kushteve minimale të jetës, si: strukturat e shëndetësisë, të arsimit, dëshira për një jetë më të mirë dhe tërheqjet e dukshme të qyteteve të mëdha, kanë çuar në një qarkullim të pakontrolluar të popullsisë rurale drejt qyteteve të mëdha, pushtim apo migrim të brendshëm. Në organizimin dhe në jetën e familjeve, të cilat u ndodhën tashmë në kushtet e një tranzicioni tipik, shpesh e reja dhe e vjetra ndërthuren, nganjëherë duke ia hapur rrugën njëra - tjetrës, ndonjëherë duke përbërë për njëra – tjetrën.

Kjo periudhë është karakterizuar nga një prirje e dukshme e rritjes së numrit të familjeve me pak fëmijë, e nxitur nga mendësia e një jete më të rehatshme, apo nga pamundësia ekonomike për të pasur shumë fëmijë. Martesat bëhen vonë, dhe kjo ndodh për shkak se parapëlqehet bashkëjetesa, e cila është gjithmonë në rritje dhe e dukshme, e rritjes së numrit të familjeve me fëmijë të pamartuar, mbasi paaftësia për të gjetur një punë, shkaktonte zgjatjen e periudhës së varësisë ekonomike të fëmijëve të rritur nga prindërit e tyre.

- Rritja e numrit të divorceve, që shpjegohet nga faktorët e mëposhtëm: liberalizimi i shoqërisë, emigracioni i madh, por edhe

shpërbërja e martesave jofunksionale. Është e dukshme prirja drejt një statusi barazie midis burrit dhe gruas në jetën familjare dhe në atë shoqërore, por rritja e papunësisë, ka efekte në mënyrë të veçantë të gratë, duke i detyruar ato që të kthehen në shtëpiake dhe të jenë krejtësisht të varura ekonomikisht nga bashkëshortët e tyre. Ndërkohë, kanë më shumë mundësi për të qëndruar afër fëmijëve të tyre, për të komunikuar me ta dhe për t'u kujdesur për ta, por kjo mënyrë jetese shpesh i hap rrugën mendësisë maskiliste, mbasi ruajtja, rritja dhe kujdesi për fëmijët është një detyrë e gruas.

Familja e madhe tashmë është ndarë, jo rrallë për të mos u bashkuar më si më përpara, rreth tavolinës së madhe, ... etj. Ata vuajnë nga ndarja dhe malli, por megjithatë jeta vazhdon, ata kanë filluar një jetë të re, duke iu përshtatur rregullave, ligjeve dhe mënyrës lokale të jetesës. Dhe kështu, pra, familjes tradicionale shqiptare i është dashur të përshtatet me ndryshimet dhe ia ka arritur, ka ecur përpara me kompaktësinë e saj, me besimin dhe respektin e normave shoqërore dhe kulturore, me lidhjet e forta ndërmjet anëtarëve të saj dhe me trashëgiminë e vlerave të përcjella të brezave të rinj, ndër të cilat mund të përmendim: respektin për vetë familjen, dashurinë për të moshuarit dhe për fëmijët, vullnetin për të punuar dhe për të ecur përpara me ndershmëri dhe me guxim.

Deri në një pikë të caktuar sjellin një rrezik për familjen, në qoftë se nuk arrijmë të ruajmë dhe të vlerësojmë, fatet e përbashkëta, të anëtarëve të familjes, që paraardhësit tanë kanë pranuar dhe kanë ditur t'i vlerësojnë?

Mos ndoshta anëtarët e familjes shqiptare tani janë duke shkuar drejt një individualizmi dhe autonomie të tepruar, duke e zbehur kuptimin e vërtetë të familjes?

Përse, sot më shumë se kurrë, në historinë e familjes shqiptare, të moshuarit gjenden të vetmuar?

Përse, sot më shumë se kurrë, shtohet numri i fëmijëve të braktisur, i divorceve, i aborteve, i konflikteve, i dhunës në formë dhe nivele të ndryshme, brenda familjes?

Mos ndoshta sot familja shikohet si një barrë, si një "pengesë" në rrugën e mundimshme të realizimit të aspiratave të veta, dhe jo si një mundësi, në të cilën secili prej nesh mëson se familja është një përcjellje, ndërtim, marrëdhënie, lidhje, bashkëndarje, mbështetje, komunikim i thellë, etj.

Megjithatë, në dallim nga dy periudhat e para, familja tani ka një mbështetje më të madhe nga strukturat e ndryshme shoqërore, ndihmohet më shumë në kryerjen e detyrës së saj, domethënë në mirërritjen e fëmijëve, por nganjëherë nuk është e gatshme që ta pranojë këtë mbështetje.

Që prej këtej fillon detyra jonë ...

Fenomeni i abuzimit mbi fëmijët si problem shoqëror, është në rritje në mënyrë të ndjeshme në Shqipëri. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit janë ndërmarrë reforma të rëndësishme nga pikëpamja juridike, po ashtu edhe përsa i përket politikave dhe shërbimeve të krijuara për të nxitur mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve.

ORIENTIME BIBLIOGRAFIKE

Historia e familjes perëndimore

- M. Anderson, *Interpretime historike të familjes 1500-1914*, Rosenberg & Sellier, Torino 1982;
- P. Ariès, *Etër dhe bij në Europën mesjetare dhe moderne*, Laterza, Roma-Bari 1968;
- P. Laslett (a cura), *Household dhe Familja në të Kaluarën*, Cambridge University Press, Londra 1972;
- E. Shorter, *Familja dhe qytetërimi*, Rizzoli, Milano 1978;
- L. Stone, *Familja, seksi dhe martesat në Angli ndërmjet viteve Pesëqind dhe Tetëqind*, Einaudi, Torino 1983.

Psikologjia dhe Sociologjia

- E. Erikson: *Fëmijëria dhe shoqëria*, 1950
- E. Erikson: *Rinia dhe kriza e identitetit*, 1968
- D. Winnicott: *Familja dhe zhvillimi i individit*, 1968
- H. Marcuse: *Autoriteti dhe familja. Hyrje historike e problemit*, 1969
- R.D. Laing: *Politika e familjes. Dinamikat e grupit familjar në shoqërinë tonë*, 1971
- D. Cooper: *Vdekja e familjes. Bërthama familjare në shoqërinë kapitaliste*, 1971
- F. Guattari: *Një varr për Edipin*, 1972
- M. Foucault: *Historia e seksualitetit*, 1976-1984
- Giovanni Paolo II: *Konsorciumi familjar*, 1981
- P.P. Donati, *Familja dhe politikën shoqërore*, 1981
- P.P. Donati, *Familja si marrëdhënie shoqërore*, 1989
- L. Giussani, *Rreziku edukativ*, 1995
- E. Scabini, *Psikologjia shoqërore e familjes. Zhvillimi i lidhjeve dhe shndërrimet shoqërore*, 1995
- D. Winnicott: *Fëmija, familja dhe bota e jashtme*, 2005
- P.P. Donati, *Manuali i sociologjisë së familjes*, 2006

Shqipëria

- Z. Dervishi, *Gratë në mes të ciklonit të sfidave dhe perspektiva* (2001)(2002) *Bashkëjetesa me demonët e konflikteve* (1999 (ribotim 2007)), Sociologjia, Shtëpia Botuese e Re e Librit Shkollor.
- R. Koçi "Të moshuarit, familja gjatë tranzicionit dhe detyrimi i shoqërisë", (1999) Gazeta "Republika", nr 142,
- G. Tushi "Kufiri" i evolucionit të familjes. Histori të rrëfyera nga paraardhësit e mi, etj.,

INDEKS:

FAMILJA: NJË REALITET QË NGAHERË E SHOQËRON NJERIUN3

PËRGJEGJËSIA PRINDËRORE DHE FAMILJA7

KONTEKSTE FORMALE TË NXËNIES DHE FAMILJA:

NJË MARRËDHËNIE QË DUHET NDËRTUAR10

FAMILJA NË POPULLIN SHQIPTAR14

TË DHËNA BIBLIOGRAFIKE18

